


8547-32

G. 75

Yje mbi Ostush

ODHISE K. GRILLO



ODHISE K. GRILLO

85H-32

85H-32

G. 79

S.

YJE MBI OSTUSH

896

SHKOLLË E SHTETËSE
TIRANE

45384

TIRANE 1968

... u ngritën në këmbë kudo, i madh e i vogël, për arësyse se vija e partisë sonë, lufta e saj heroike i ka lidhur njerëzit ngushtë me njeri tjetrin, popullintonë e ka bërë të mendojë, të luftojë dhe të ndjejë si një trup i vetëm, të mendojë, të ndjejë dhe të luftojë si revolucionar i lavdishëm.» *)

ENVER HOXHA

*) Nga fjala e mbajtur në Peshkopi.

KEMISHA

I

Ajo nuk ngjante me një rrugë automobilistike të asfaltuar. Ngjante me një gjarpër të stërmadh e të akullt, që sillej rreth trupit të kodgeve e të maleve dhe zhdukej tej, në bardhësi. Sa e ftohtë që ish rruga! Sa e bardhë! Dukej si xham.

Nga të dy anët e saj, bora shtrihej gjer tutje, në horizont. Rruga qe e ngrirë: borë e përzier me baltë. Aty e bardhë fare, aty gri, aty kafe si në të kuqe. Ylber ngjyrash. Maqina ecte ngadalë, sikur e shtynte shoferi me supe. Madje nuk ecte. Ajo rrëshqiste dhe ata që ishin brenda kujtonin se do të binin nga një çast në tjetrin. Aty ndalonte, aty zvaritej, aty rrëshqiste. Nën rrota akull. Mbi karroceri binte borë.

Maqina ecte drejt veriut. Kish hyrë në ditën e dytë që udhëtonte drejt Peshkopisë. Nga pas e ndiqnin maqina të tjera. Një, dy, tri... dhjetë

të... njëqind... njëmijë. E kush mund t'i numëronte ato? Ndofta i numëronin fëmijët, që kanë qejf të mbledhin targat. As njerëzit që shkonin drejt veriut, nuk numëroheshin dot.

Maqina ish mbushur me njerëz. Ishin të gjithë të rinj. Vajza dhe djem. Këndonin. Bënin shaka. Me këngë dhe shaka mund të kalohet një rrugë e gjatë plot me rreziqe. Me këngë dhe me shaka mund të kalohet një rrugë, ku ecet ngadalë, ku të pengon akulli, ku të pengojnë maqinat që shkojnë dhe kthehen, era e fortë, bora që bie.

Nga pas vinin maqina të tjera. Me njerëz, me tulla, me lëndë druri, me tjegulla, me çimento. Kish edhe me dyer e dritare. Me gjithçka do një shtëpi për t'u ngritur.

Përpara doli një e përpjetë. Në fund të së përpjetës u duk një maqinë. Kish ndaluar.

— Me siguri na lëshoi rrugë, — mendoi shoferi. Dhe bëri përpara.

E përpjeta qe thikë. Mund të rrëshqisje nga një çast në tjetrin. Dhe pastaj të prisnin valët e Drinit. Sa i egër që qe Drini! Mirë ia kanë vënë emrin: Drini i Zi! Maqina uturinte. Mezi doli lart edhe kish zinxhirë.

Një shofer, veshur me kominoshe, rrinte në mes të rrugës dhe bënte shenja me duar. Anash, si roje nderi, rrinjin shumë vajza. Të gjitha veshur me tuta. Njëra e kish kokën të lidhur me fasha. Stefani e pa që nga xhami i maqinës dhe i thirri shoferit:

— **Ndaloje, se diçka ka ndodhur. Më duket se ka të plagosur.**

Dikush shtoi:

— Mos ka pësuar gjë maqina...

Shoferi ndërroi marshin dhe tha:

— Do të ndalojmë patjetër. Maqina ka zënë rrugën dhe nuk kalojmë dot.

Shoferi mbajti krahun dhe pas pak maqina, e cila vinte e para, ndaloi. Zbritën të gjithë. Përpara: maqina që kish zënë rrugën. Prapa: me dhjetra maqina, që rrinin njëra pas tjetrës, si vagonët e një treni gjigant, që nuk i dihet fundi.

Shoferi hipë në kabinë dhe po u bënte shenja me duar maqinave që vinin pas. Të tilla shenja nuk i përmban rregullorja e qarkullimit të maqinave. Ato i dinë vetëm shoferët. Ata i kuptuan shenjat dhe, si me komandë, zunë krahun e ndaluan. Dyert e kabinave u hapën dhe prej tyre dolën shoferë, vullnetarë, specialistë. Të gjithë u drejtuan nga kreu i kolonës.

Ata të maqinës së parë, bashkë me shoferin e tyre, u afroan te grupi i vajzave. Shoferët shtërguan duart. Shkëmbyen edhe cigare. Të tjerët u përshëndetën. Dikush duke tundur kokën. Dikush duke buzëqeshur.

— Hiqe njëherë, — tha Stefani dhe i dha shoferit me kominoshe një shishe me raki.

Shoferi me kominoshe e mori, e vuri në buzë dhe u gëlltit dy tri herë.

— E fortë, po e dashur...

— Kështu e kemi rakinë ne nga Himara.

— Edhe njerëzit të dashur janë, apo jo?

U Afruan edhe vajzat, Ishin njëzet e pesë,
Të gjitha të veshura me kominoshe. Në qafë mba-

nin shallin e aksionit. Njëra kish lidhur kokën me fasha. Në një kënd fasha ish gjakosur. Ish ajo vajza që kish parë Stefani nga xhami i maqinës.

Stefani pa edhe një tjetër të plagosur. E kish dorën të lidhur.

Shoferi i maqinës së parë pyeti:

— Po këto shoqet ç'kanë?

Njeri tha:

— Ndonjë karambol i vogël.

Shoferi me kominoshe qeshi. Qeshi me gjithë zemër.

— Karambol, ë?... Asnjëherë nuk kam pësuar karambol në jetën time. Kam njëzet vjet në timon. Ju kujtuat se përplasa maqinën dhe i plagosë unë. Jo, more vëlla! Janë plagosur nga tërmeti.

Disa pëshpëritën:

— Nga tërmeti?!

— Kësaj, — dhe tregoi atë që kish lidhur kokën, — i ka rënë një tra në kokë. Asaj tjetrës, — dhe tregoi atë që e kish dorën të lidhur me fashë, — i ka rënë një tullë. Gjëra të lehta... Ma jep atë shishen ta heq edhe njëherë se ngriva.

Stefani u afrua. U fut në mes të shoferit me kominoshe dhe të vajzave.

— Po për ku kështu me këto të plagosura? Në spital?

Ndërkohë arritën të tjerët. Vajza me kokë të lidhur tha:

— Për në hekurudhë!

— Shqipëria po vjen në Dibër kurse ju po ikni?! — i tha Stefani.

Vajza me kokë të lidhur doli në krye të shoqeve.

— Ne jemi njëzet e gjashtë të reja nga katush. Katër janë të plagosura lehtë. Një është plagosur rëndë. Është në spital. Sa të shërohet, do të vijë edhe ajo me ne. Para se të binte tërmeti, ne kishim vendosur të shkonim në hekurudhë. Dhe ja ku po shkojmë. Jo tërmeti, po as gjë nuk mund të na ndalojë. Tërmeti ra, bëri dëme, plagosi njerëz, po ne bëjmë punën tonë. Jeta vazhdon.

Shoferi me kominoshe tha:

— Kjo është komandantja e tyre. E quajnë Lume.

Stefanit i pëlqeu kjo vajzë. Fliste ngadalë. Zërin e kish të fortë. Ish edhe e bukur. Edhe të tjerëve u pëlqeu.

Lumja pyeti:

— Edhe ju jeni vullnetarë e specialistë, apo jo?

Stefani, duke e shikuar drejt në sy, tha:

— Ne jemi 129 të rinj nga Vlora dhe fshatrat e saj. Kemi ardhur për të zëvendësuar 129 të plagosurit e rrëthit tuaj. Shoqet dhe shokët e tjerë janë prapa. Ne ndaluam që t'ju ndihmojmë. Kujtuam se kishit pësuar gjë.

— U kthye më mirë nga Lumja dhe e pyeti:

— Sa të plagosur ka fshati juaj?

— Nëndë, — tha Lumja. — Ne të katra, ajo që është shtruar në spital dhe katër të tjerë.

— Edhe ne që vimë nga Himara, nëndë vetë jemi. Në Ostush na kanë caktuar të shkojmë. Do

t'ju zëvendësojmë juve dhe pesë të tjerët. Unë do të të zëvendësoj ty. Si të duket?

Lumja uli kokën.

Binte borë dhe frynte erë. E ftohta të hynëtë në palcë. Të gjithë, pa komandë, lëviznim sikur të bënin «në vend numëro».

Shoferi i maqinës së parë i tha shoferit me kominoshe:

— Të ka pësuar gjë maqina!

Tjetri foli si me pahir:

— Maqinës sime i është shuar motori. Nuk ndizet. Është ftohur.

— Ashtu?!

— Epo, atëhere duhet të të ndihmojmë. Vajzat duhet të shkojnë sa më shpejt në hekurudhë. S'bën të rrinë në mes të rrugës.

— Edhe ju duhet të shkoni sa më parë, se ju presin.

Shoferi i maqinës së parë hodhi sytë rreth e qark dhe pa rrugën. Nuk mund ta tërhiqnin. Rruga ish e ngushtë dhe e tatëpjetë. Pastaj ish edhe e ngrirë. Mund të rrëshqisnin. Pa edhe njëherë para e prapa, gjeratje ku rruga zhdukej në bardhësi. Asnjë lëvizje.

— More, po nuk ka traktor këtu? Andej poshtë kishte shumë.

— Ka, si nuk ka. Atë po presim edhe ne, — tha Lumja.

Shoferi i maqinës së parë tha:

— Sa të vijë traktori, ne do të bëjmë punën tonë. O burra të ndezim zjarr poshtë motorit që të ngrohet! Mblidhni ca dru t'i lagim me benzinë.

— Kështu shkon gjatë shumë... Gjersa të ngrohet, do të vijë traktori.

Një burrë qimekuq u fut në mes të të tjerëve:

— E dini si them unë?

— Hë, folë!

— Jemi gjithë këta burra, apo jo?

— Edhe gra.

— Po, edhe gra. Ta shtyjmë maqinën më supe gjer në rrëzë të kanalit dhe të hapim rrugën. Na presin. S'mund të rrimë për një maqinë këtu.

— Ashtu?!

Njeri u nxeh dhe tha:

— Ti shikoke vetëm lëkurën tënde!

Një tjetër shtoi:

— Dashke t'i lemë njëzet e pesë vajzat në mes të rruqës, ë? A e di ti se ku shkojnë këto? Po ta them unë! Shkojnë në hekurudhë! Ka edhe të plagosura në mes të tyre.

— Kur qenka kështu... të më falni...

Burri qimekuq u tërhoq dhe iku tatëpjetë xhadesë.

— Si do të bëjmë?

— Të presim sa të vijë traktori.

— Të kthehet një maqinë dhe të vejë të lajmërojë.

— Këtu s'ke ku kthehesh. Sëprapthi nuk ecet as një metër.

— Epo, atëhere të presim.

Flisnin me radhë e pa radhë. Flisnin shoferë, vullnetarë, specialistë e vajza. Stefani rrinte dhe dëgjonte. Nganjëherë shikonte Lumen. Edhe lumja e pa disa herë. Me siguri ajo thosh me vete:

«Po ky, ku shkon kështu si në dasmë? A shkohet rrëzë Korabit me një xhaketë të vogël dhe me gjoks jashtë? Ku kujton se është, në Himarë dhe lahet me ujët e Jonit? Këtu ka borë dhe erë. Ka akull dhe tufan. Duhen kapuça, çizme dhe gozhupë.»

Stefani mendonte ndryshe:

«Këto janë nisur për në hekurudhë. Ka edhe të plagosura. Pse të rrinë dhe të presin në këtë të ftohtë? Pastaj kushedi sa vonon traktori. Duhen ndihmuar. Duhet të shkojnë sa më parë në hekurudhë. Apo jo, Lume? Edhe ne duhet të nisemi. Dibra pret njerëz, pret materiale. Apo jo, Lume?»

Stefani u tha shoferëve:

— Më sillni një kovë me benzinë!

— Ç'të duhet?

— O po silleni ju, se jua tregoj unë.

Shoferi me kominoshe solli një kovë me benzinë.

Stefani tha:

— Hapeni mbulesën e motorit.

Ata e hapën. Asnjeri nuk guxoi ta pyesë.

Stefani hoqi xhaketën e vogël dhe e vuri mbi parafango. Hoqi edhe trikon blu, me mëngë të gjata, që ja kish bërë e motra. Pastaj hoqi këmishën. Ish një këmishë e thjeshtë prej fanellate. Ish nga ato që shohim çdo ditë nëpër vitrinat e mapove. Mbeti në kanatjerë. Ai zvishej, kurse të tjerët dridheshin nga të ftohit.

«Himarjot jam, moj Lume, — thosh Stefani me vete, — po nuk pyes nga të ftohit. Unë jam

lakuriq dhe ti, që je dibrane, mërdhin.»

E mori këmishën dhe e futi në kovë. E shtyu brenda me një copë dru. Pastaj nisi të veshë trikon dhe xhaketën.

Lumja mendonte:

«Sa i fortë! E ka pjekur rëra dhe dielli! Shiko ç'muskuj që ka! Nuk pyet ky as borë, as erë. Ky mund të përleshet me një ari dhe ta verë poshtë.»

Asnjë nuk foli për shumë minuta. Të gjithë mbanin frymën, si të ishin në një sallë operacioni. Shoferi i maqinës së parë e theu heshtjen:

— Ç'bën kështu? Po ti mbete lakuriq... Shaka janë këto?

Stefani ngriti kokën dhe shikoi nga Lumja.

— Në fshatin e Lumes do të ketë patjetër dy-qan të konsumit. Do të blej një tjetër atje. Mbase edhe më të bukur. Apo jo, Lume?

Lumja tha:

— Ka. Madje ka këmishë edhe si kjo jotja.

Ajo tregoi këmishën që ish futur në kovë dhe që po ngopej me benzинë.

Stefani e nxori këmishën nga kova dhe pë-shtolli kolektorin. Pastaj ndezi shkrepsen dhe i vuri zjarrin. U ngrit një flakë e kuqe në fillim, që më vonë mori ngjyrën e qiellit. Nisi të vijë era shkrumb. Doli edhe tym i zi.

Shoferi me kominoshe hipi në kabinë dhe lë-vizi çelësin. Kur këmisha ish djegur fare, u dë-gjua uturima e motorit. Të gjithë buzëqeshën. Buzëqeshi edhe Lumja. Edhe Stefani vetë.

— Ja një gjë që nuk e dinim, — tha shoferi me kominoshe.

— Kush ta ka mësuar, Stefan?

— Im atë. Ai ka qenë shofer. Kur isha i vogël, më merrete me vete në maqinë. Njëherë nge-lém në Llogora. Ish dimër. Kish rënë borë. Si sot. Na u shua motori. U ftoh. Babai nuk e humbi. Du-hej të shkonte në Vlorë atë ditë. Nxori këmishën, e lagu me benzinë, mbështolli kolektorin dhe i vuri shkrepsen. Ja kështu bëri babai. Unë nuk e kam harruar këtë.

Shoferi i maqinës së parë tha:

— Epo, tani të ndahemi, se u bë vonë...

Të gjithë shtrënguan duart e njeri tjetrit. Edhe Stefani me Lumen i shtrënguan. Ndofta pak më gjatë e më shumë se të tjerët. Kur u ndanë, të dyve u digjnин duart e faqet dhe veshët.

Hipën në maqina. E para u nis maqina me vajzat e Ostushit. Dibranet mbështetnin kokën te xhamat dhe përshëndetnin me shallet e aksionit. Përshëndeste edhe Lumja. Cilin vallë përshëndeste? Të gjithë. Me siguri të gjithë i përshëndeste. Po më tepër Stefanin.

Edhe ata që vinin nga jugu nxorën kokat në dritare e përshëndetën. Përshëndeti edhe Stefani. I përshëndeti të gjithë: shoferin me kominoshe dhe të njëzetepesë vajzat. Përshëndeti edhe Lumen.

Sa e bukur që ishte Lumja! Edhe e gjatë. Edhe e fortë. Dhe fliste si burrë! Ç'vajzë... Tammam dibrane nga ato që këndohen nëpër këngë.

— Merre!

Mendimet ja ndërpren Genti. Stefani ktheu kokën dhe pa shokun me një këmishë në dorë. E

mori. Hoqi xhaketën e trikon. Veshi këmishën që i dha shoku. I vinte pak e ngushtë, po ishte e ngrohtë. Pastaj veshi trikon dhe xhaketën.

— Faleminderit, Gent!

— Ç'faleminderit, ore! Unë dua një dush të mirë, se u kujtova vonë.

— Më mirë vonë se kurrë, — tha dikush nga fundi.

Një tjetër zuri të tallet:

— Ky Genti është djalkë i mamasë. Sa këmisha ka marrë me vete, thoni ju? Dhjetë janë pak.

Një tjetër shtoi:

— Po hekurin për të ngrirë jakat, e ke marrë?

Ata qeshnin dhe bënin shaka. Stefani nuk i dëgjonte fare. Ai mendonte:

«Ç'gjera që ndodhin te ne! Ne vijmë nga jugu për të ndihmuar të dëmtuarit nga tërmeti. Të dëmtuarit, edhe pse të plagosur e me të afërmit jashtë, në bor e tufan, shkojnë në hekurddhë. Ç'ditë që po kalojmë. Ja këto janë heroizmat dhe këta janë heronjtë.»

Dikush thirri:

— Të zbresin të Ostushit!

Maqina ndaloi. Ish errur. Stefani zbriti me trastën e veglave në krahë dhe përhëndeti ata që do ta vazhdonin rrugën. E para sië që i ra në sy, posa vuri këmbët në tokë (në akull më mirë), që një fener që ndriçonte pak më tej me një dritë të zbetë. Andej, nga feneri, u dëgjua një zë plaku:

— Këndeje, shoqe dhe shokë, këndeje!

Dhe lëvizi fenerin. Stefani bashkë me shoqet e me shokët e tij u drejtua për nga njeriu me fener. Maqina u zhduk. Tani dukeshin vetëm dritat e maqinave, që thyeshin e kryqëzoheshin në-për faqet e kodrave. Nga pas vinin me dhjetra maqina të tjera. Çapiteshin përpara. Uturinin.

Stefani ju afrua plakut me fener në dorë.

II

PLAKU ME FENER NË DORE

PLAKU me fener në dorë u takua me të gjithë. Në fillim me të dy vajzat, pastaj me djemtë. I pyeti:

— A mërdhitë, o shokë?

Dikush tha:

— Si do të mërdhinim ne, kur nuk mërdhi ti që je plak?

— Ashtu është... Po unë jam mësuar. Ju vini nga vende të ngrohta.

Stefani ju afrua edhe më:

— Nuk kanë caktuar ndonjë të ri për të shqëruar vullnetarët dhe specialistët? Ty të gjetën që je i shkuar në moshë?

— E kërkova vetë këtë punë. Bredh sa në një shtëpi në tjetrën, sa në një rrugë në tjetrën, sa në një lagje në tjetrën. Pres njerëz, kafshë, materiale. Tjetër gjë nuk mund të bëj dot. Nuk më

896

rrihet në një vend. Pastaj kam dëshirë të takohem me sa më shumë njerëz.

Plaku ndaloi, u kthyte nga himarjotët dhe tha:

— Si thoni ju, të rrija duarkryq tani që punojnë edhe fëmijët? Duhet të bëja edhe unë diçka. Ç'do të thoshte ime bijë, që e kam në spitalin e Peshkopisë, kur të merrte vesh se unë rrija duarkryq?

E pyetën dy tre vetë bashkë:

— Çfarë të ka vajza?

— Është plagosur rëndë nga tërmeti. Po do të shërohet. Më thanë vetë doktorët që të mos kem merak. Ajo do të shërohet. Dhe pastaj do të shkojë në hekurudhë. Për mua do të kujdeset gjithë fshati. Pastaj unë kujdesem edhe vetë. Nuk jam edhe aq plak.

— Mos është vajza jote ajo që do të shkonte vullnetare në hekurudhë me njëzet e pesë vajzat e Ostushit?

— Vetë dora.

— Po si u plagos?

— Ishte në shtëpi, bashkë me të vëllanë.

Stefani me shokët e tij ecnin pas plakut me fener në dorë dhe e dëgjonin tek fliste ngadalëngadalë. E dëgjonin, po nuk e shikonin në fytyrë. Nuk shikonin si i ishin njomur sytë. Ecni. Këmbët u futeshin thellë në borë. Ujët u hynte nga këpucët. Sa vinte dhe e ndjenin më tepër të ftohtin.

— Ime shoqe ish pak e pamundur dhe fëmijët u ndodhën brenda kur ra tërmeti. I shërbënin nënës. U tund vendi dhe shtëpia ra. I zunë trarët; i zuri tavani, çatia, muret. I zuri krejt shtëpia nën

vete. Vajzën e nxorën të plagosur. Djali dhe gru-
aja...

Plaku nuk e vazhdoi dot fjalën dhe nisi të
gëlltitet. Pastaj tha:

— Nuk qaj, jo... E kam nga pleqëria.

Stefani bëri një hap përpara dhe i hodhi kra-
hun.

— Të të rrojë vajza... Si e ka emrin?

— Lutfie.

— E gëzoftë.

Edhe një tjetër i vuri krahun. Ishte Genti. I
zgjati paketën dhe plaku mori një cigare. Dikush
ja ndezi. Një copë herë ecën pa folur. Kur zbritën
në një shesh të vogël, Stefani e pyeti:

— Po shtëpinë ta ndërtuan?

Plaku ndaloi. Ndaluani edhe të tjerët.

— Shtëpinë deshën të ma ndërtonin mua në
fillim. Po unë nuk pranova. Edhe vajza ashtu më
porositi. Shtëpia jonë do të ndërtohet në fund fa-
re. Unë një plak jam. Mund ta fut kokën ku të je-
të. Rregullohem unë. Më përpara të ndërtohej
shkolla. Dhe u ndërtua për tri ditë. Pastaj shtëpi-
të e atyre që janë më keq e që kanë fëmijë të ve-
gjël. Ata duhet të mblidhen rrëth vatrës së re dhe
të ngrohen. Edhe imja do të ndërtohet. Po në fund
fare.

Stefani mendonte:

«C'gjëra që po ndodhin! Dy të vrarë dhe një
të plagosur në shtëpi. Dhe ky plak bredh ditë e
natë për të pritur e përcjellë vullnetarët, specia-
listët dhe materialet. Dërgon edhe vajzën e plago-

sur në hekurudhë. Dhe nuk pranon t'i ndërtohet shtëpia të parit! Ç'kohë po jetojmë! Me ç'njerëz po takohemi! Ja, ky plaku me fener në dorë është hero. Një hero i ditëve tonë!»

Dhe vazhdonin të ecnin nëpër borë. Frynte erë. Drita e fenerit lëpihej nëpër faqet e xhamta, dhe hollohej. Gati sa nuk shuhej. Çorapet u ishin bërë ujë dhe këmbët u ishin ftohur fare. Copa akulli u ishin bërë.

— I kemi pak larg shtëpitë. Po të rejet do t'i ndërtojmë afër e afër. Të afrohemë ca. Drita e elektrikut do të na afrojë edhe më shumë, apo jo? Ne, nga veriu, duhet të afrohemë, se i kemi patur shtëpitë larg e larg.

— Edhe ne nga jugu.

— Duhet të hapni edhe dritaret. Të hyjë më shumë dielli, ajri.

— Ja ku duket një shtëpi. E shihni? E mere-metuam shpejt e shpejt dhe aty banojnë traktoristë, shoferë, specialistë, vullnetarë dhe nga ata që shkruajnë. E harroj gjithmonë atë fjalë...

— Gazetarë?

— Jo, jo. Nga ata që shkruajnë libra.

— Shkrimtarë atëhere.

— Të lumtë goja. Ata vetë janë.

«Qënka hotel për të gjithë», — mendoi Stefani.

— Aty do të rrini edhe ju, — tha plaku.

Stefani ju përgjegj:

— Sonte rregullona si të na rregullosh. Nesër do të ngremë çadrat që kemi marrë me vete. Kemi

dy. Në njerën do të flenë tre vetë. Në tjetrën katur. Nuk duam të ngushtojmë të tjerët. Këto vajzat do t'i rregulloni ju.

— Do t'i çoj te shtëpia e Myftarit. Shtëpia e tij u meremetua nga të parat, se nuk kish ndonjë dëm të madh. Ka vend plot atje. Djalin e ka ushtar Myftari. Vajza i iku sot për në hekurudhë.

— Mos ish me ato që takuam në rrugë?

— Po. E kish kokën të lidhur. U plagos edhe ajo si vajza ime. Po më lehtë.

Stefani mendoi:

«Me siguri, vajza e Myftarit është Lumja.»

Dhe tha:

— Mos ish ajo komandantja?

— Dora vetë.

Ecën edhe pak pa folur. Plaku ndaloi dhe drejtoi dorën me të cilën mbante fenerin.

— Erdhëm. Ja ku është shtëpia.

Genti ju afrua Stefanit.

— Do t'i ngremë çadrat që sonte?

— Do të bëjmë si të bëjmë këtë natë. Nesër do t'i ngremë.

Plaku tha:

— I ngrini pranë çadrave të ushtarëve. As ata nuk pranuan të flenë nëpër shtëpi. «Ju ngushtojmë, thoshin. — Do të flemë nëpër çadra. Le të flenë të tjerët nëpër shtëpi. Le të flenë ata që nuk kanë çadra». C'njerëz, ë?.. Dhe, meqë ra fjala për ushtarët, dëgjoni këtu: punëtorë si ata nuk ka. S'hahet asnë me ushtarët.

Aty afér kaluan dy vetë të armatosur. Folën së bashku:

— Mirseardhët, o shokë!

Himarjotët u përgjegjën:

— Mirsejugjetëm!

Të armatosurit u larguan.

— Po këta, ushtarë janë?

— Jo. Bëjnë roje ditë e natë këndeja. Lumi fle, po hasmi jo. Kemi Titon këtu afér.

Dhe plaku shtriu dorën tej, nga kufiri.

Të nëndë tok u futën në shtëpinë që u tregoi plaku. Sa vuri këmbët te dera, plaku tha:

— Ju solla miq të rinj. Janë nga Himara e portokalleve.

Të gjithë u ngritën në këmbë dhe hapën vend rreth sobës. Një shofer me xhakavento lëkure ju drejtua plakut:

— Xhaxho, leri portokallet, se ato janë përfëmijët. Kanë sjellë ndonjë shishe verë me vete?

Në dhomë ishin shtruar gjithë ata dyshekë. Në mes ishte soba. Tubat skuqnin. Njerëzit bisedonin dhe tymosnin. Disa flinin. Njëri këndonte, duke i rënë kitarës:

«Marjank' e vogël ti më je,
me syçkat bojë qielli...»

Dikush tha:

— Leri të bredhin nëpër bulevarde Marjankat, merrja këngës për ndonjë revolucionare, që ndërton shtëpi nëpër borë.

Shoferi me xhakavento lëkure tha:

— Këtu s'ka vend. Lart është më lirë. Dyshekë e batanie ka plot.

U ngjitën lart tē nëndë. Një dhomë pothuaj-se qe bosh. U futën brenda, lanë plaçkat dhe u ulën afër sobës. Dy vetë që ngroheshin, u hapën vend. Stefani la çantën në një kënd dhe tha:

— Unë me plakun po shkojmë tē çojmë shoqet në shtëpinë e Myftarit.

Pandora, një nga tē dy vajzat, shtoi:

— Edhe në tē Lumes.

Himarjotët qeshën. Qeshën edhe tē tjerët. Qeshi edhe plaku.

U nisën. Shtëpia e Myftarit qe shumë afër. Prapa saj ishin çadrat ku flinin ushtarët. Ato po-thuajse nuk dukeshin fare në mes tē borës. Dukej vetëm tymi që nxirrin sobat.

Trokitën në një derë tē madhe me strehë tē gjerë. Një burrë e një grua dhe tre katër fëmijë dolën me vrap në shkallë. Plaku tha:

— A do miq, o i zoti i shtëpisë?

Burri, duke zbritur shkallët, thirri:

— Bujrum!

Dhe dera e oborrit u hap.

Plaku, vajzat dhe Stefani u futën në dhomën e zjarrit. Më parë u futën vajzat, pastaj tē tjerët. Në vatër digjej një zjarr i madh. Pas një rruge kaq tē gjatë e tē lodhshme, zjarri tē ftonte për t'u shplodhur.

Vajzat i ulën në krye. Në zjarr vunë xhevzen. Matanë po piqeji kafe. Këndeji erdhi era e këndsh-me dhe i shpoi në hundë mysafirët. Edhe plakun. Stefani ndjeu një kënaqësi tē madhe. Futi dorën në xhepin e xhaketës dhe nxori tri kokrra man-darina, që i kishin mbetur. Ua dha fëmijëve.

— Këto kam, o vogëlushë.
Ata zgjatën duart.

— T'i ndani të katër, ë! I ndani dot?
Myftari shkrepri zjarrin me mashë, afroi pru-
shin nga mikeshat dhe tha:

— I ndajnë, si nuk i ndajnë.
Plaku, duke ndezur cigaren, shtoi:

— Edhe po të mos dinë, do të mësojnë nga
ju që erdhët të ndani dhimbjet dhe hidhërimet tok
me dibranët.

— Edhe me librazhdasit, — shtoi Myftari.
— Jemi vellezër, — u përgjegj Stefani.

III

NËN RROTAT E MAQINËS

ATË natë pothuajse nuk fjetën fare. Poshtë, ai korçari me kitarë nuk pushonte së kënduari. Dëgjohej mirë edhe një që gérhiste.

Herëpashere hynin e dilnin njerëz. Dikush thërriste me të madhe, sikur të mos kish të tjerë që flinin rrëth e rrotull.

Po gjashtë himarjotët i zuri gjumi. Ishin të lodhur. Në fillim kishin të ftohtë. Po i ngrohu soba. Dhe ngrohtësia ndolli gjumin. U mbështollën me batanie këmbë e kokë dhe fjetën. Po jo shumë. Për herë të parë i zgjoi Stefani. Erdhi duke vërshtellyer. Ish ngrohur mirë te Myftari. Kish ngrënë e kish pirë. Lodhja i kish ikur.

Dikush, nga nën bataniet, mezi u dëgjua tek fliste:

— Ej, Stefan! Po flenë shokët. Leri fishkëllimat për nesër.

— Më falni...

Kaq u desh. U zgjuan tē tērë dhe nisën ta pyesin pér Vojisavën dhe pér Pandorën. Stefani u tregoi se ishin rregulluar pér bukuri. Nuk kish ku tē shkonte më mirë. As në shtëpitë e tyre nuk do tē ishin aq rehat. Myftari ish mikpritës i madh.

Genti e ndërpreu:

— Kështu janë gjithë dibranët.

Stefani vazhdoi:

— E dogji Myftari pér himarjotet. Edhe pér mua. Po e dini? Myftari ka qenë edhe në Himarë.

— Kur?

— Pér herë tē parë më 1935. Pér herë tē fundit më 1943. Vinte punonte ullinjtë e kapeda-nëve tē fshatit.

Njeri tha:

— Mua më kujtohet kur vinin dibranët dhe matjanët me nga një bel tē gjatë e punonin ullinjtë e pasanikëve. E di si ngjanin me bel në krah dhe tē lartë gjer atje sipër? Si Polifemi, që mësonim në histori.

— Ama tē mësuar, ë? Mësonim pér Polifemin dhe nuk dinim asgjë pér Nase Benin.

— Nasen e njihte populli dhe i këndonte këngët.

— Ç'këngë tē bukura që ka bërë! Muzikë fare!

Të penës e tē dyfekut,
aman trima kapetanë,
i tregojn' gjoksin dovletit,
si zogjtë në tramundanë.

Genti e ndërpreu:

— Vargu i parë duhet rregulluar. Kur ta këndojojmë këtej e tutje duhet të themi:

Të punës e të dyfekut...

Kështu shkon më mirë.

— Nuk e ke keq... Po lejohet një gjë e tillë?

— E pse jo? Nasja doli nga populli, këndoi për popullin dhe populli po ja ndryshon këngët.

— Ja shkulim njëherë?

— Je në vete? Hajde të flemë tani. Natën e mirë.

Dhe u shtrinë të shtatë. Asnjë nuk foli më. U vërtiten e u vërtiten nëpër batanie gjersa i zuri gjumi. Soba ngrohte në mes të dhomës. Gjuhët e flakës delnin nëpër të çarat e tubave dhe dhoma herë ndriçohej e herë mbetej në gjysmerrësirë.

Në shkallë u dëgjuan këmbë. Dera e dhomës u hap duke kërcitur dhe brenda hynë dy vetë: një djalë i ri dhe një burrë i thyer, me beretë në kokë. Ecnin në majë të gishtrinjve. Ju afruan sobës dhe njeri prej tyre, ai më i riu, ndezi llambën.

Burri i thyer, me beretë në kokë, hodhi sytë nëpër dhomë dhe tha:

— Paskan ardhur miq të rinj, më duket.

Qenkemi shtuar.

Tjetri nuk u përgjegj. Himarjotët u zgjuan përsëri.

— E, more shokë, nga ju kemi? — pyeti më i riu.

— Jemi nga Himara.

— Nga Himara e «Vaizës së valëve?» Shumë mirë, shumë mirë. Vec na falni, se ju prishëm gjumin.

Burri i thyer, me beretë në kokë, u kthye nga shoku:

— Shiko sa gjë interesante! Njerëz të ardhur nga jugu në veri... Si thua Agim? Për ty, si gazetar, është një fakt i bukur shumë. Jugu i shtrin dorën veriut... Bëj diçka të bukur dhe dërgoje qysh nesër.

— Edhe për ty, si shkrimtar, është interesante, apo jo? U plagos Shqipëria në një krah. Dhëmbjen e ndjeu gjithë Shqipëria. Ashtu siç e ndjen trupi i njeriut, apo jo? Dhe nga të gjitha anët rendën njerëzit për të shëruar plagën. Kështu rendin edhe ruazat e gjakut në trup, apo jo?

— Krahasim shumë i bukur. Ta vesh patjetër në reportazh. Unë për vete do ta shënoj, se mund të më dalë nga mendja.

Stefani u ngrit nga rrrobet dhe u afroa te soba.

— Po ju nga jeni, o shokë?

U përgjegj burri i thyer, me beretë në kokë:

— Jemi nga vende të ndryshme. Unë jam nga Gjirokastra. Ky tjetri është nga Korça. Punojmë në Tiranë. Shoku është Agim Dolli. Punon në «Zërin e popullit».

— Ja kemi dëgjuar emrin. Shkruan gjithnjë. Edhe dje kish shkruar diçka. Njëherë ka shkruar edhe për vëllezërit Gjikënuri nga Kudhësi i Himmars. Ke dëgjuar për ta, o shok? Janë të tre dëshmorië.

Agimi tha:

— Ashtu është. Për ata vëllezër duhet shkruar një roman... Më vjen keq që nuk jam roman-

cier. Do të dilte një roman i mrekullueshëm nga Lufta Nacional-Çlirimtare.

Burri i thyer, me beretë në kokë, vazhdoi:

— Ndërsa unë jam shkrimtar.

— Gëzohem.

Ishin ngritur edhe të tjerët dhe po rrinin ndenjurazi në të shtruarat. Genti e pyeti shkrimtarin:

— Shoku shkrimtar, si thoni ju, fjalët e një këngë që kâ ngritur Nase Beni, një fshatari ynë, a mund t'i ndryshojmë? Ai thotë kështu në një këngë:

Të penës e të dyfekut...

Ne duam ta bëjmë:

Të punës e të dyfekut.

— Shumë mirë do të bëni. Kjo është një këngë e bukur. E kam dëgjuar në Radio Tirana nga grupei himarjot.

Agimi qeshi dhe tha:

— Ju s'po ndryshoni asnje fjalë këtu. Po ndryshoni vetëm një gjermë: e-në po e bëni u. Gërmat e tjera ngelën njëlloj. Nga pena bëhet puna.

Shkrimtari tha:

— Ju flini, se ne kemi punë. Unë do të rregulloj shënimet, ndërsa Agimi do të bëjë një reportazh. Vijnë nga Shupenza dhe kemi parë gjëra të habitshme.

— Na tregoni ndonjë gjë...

— Me gjithë qejf, po është vonë. Do t'i lexoni në gazetë. Është më mirë kështu. Shplodhuni tanë, se nesër do të filloni nga puna që menatë.

Stefani me shokët u shtri. Shkrimtari dhe gazetari ulën kokat përmbi bloqe dhe shkruanin.

Ndaj të gdhirë, kur u zgjuan nga një e thirrur e fortë, gazetari me shkrimtarin po shkruanin ende.

Ai që thirri kish qenë një shofer. Kërkonte traktoristin. I kish ngelur maqina në mes të rrugës dhe s'kish burrë që e lëvizte. Traktoristi sapo ish shtrirë dhe ende nuk i ishin mbyllur mirë sytë.

Shoferi vazhdonte të thërriste:

— Hajde, tundu, se kam zënë rrugën! Kam penguar gjithë qarkullimin.

Traktoristi u ngrit dhe doli te dera. Ish i gjatë e i trashë. Kokën e kish të qethur rrafsh. E pat rruar disa ditë më parë. Xhaketën e kish prej lëkurë bojë kafe. Në kurriz i dukej një njollë e zezë. Edhe në supin e majtë. I bërtiti shoferit:

— Pse e zure rrugën?

— Pse, desha unë dhe e zura? Rrëshqiti maqina dhe u shua.

— Ec, more, se të njoh unë ty! S'je për shofer ti, more babaxhan. Ti duhet të lëpish karamele në ndonjë pastiçeri të Tiranës.

— Mua më thua kështu?

— Ty!

— A e di ti se unë kam dy medalje pune, apo jo?

Dhe i ra gjoksit. Tjetri e uli zërin:

— Mos u nxeh, mor shok. Jam nëpër gjumë prandaj flas kështu. Të ngatërrova me një tjetër.

Shoferi ju afrua dhe i ra shpatullave traktoristikët.

— Se mos desha unë... Gjëra që ndodhin.

U afrua edhe një tjetër. Ishte Sherif Kajca, anëtari i shtabit të lokalitetit. Po vinte nga vendi ku kish rrëshqitur maqina. U drejtua nga ata që ishin rreth e rrotull:

— Do të marrim edhe disa shokë me vete. Kanë rënë trarët dhe duhen ngritur.

— Ej, kush del vullnetar?

— Këtu të gjithë janë vullnetarë.

— E di, e di. Po tani duhet të dalin vullnetarë nga vullnetarët.

Nga shkallët zbritën të shtatë himarjotët.

— Vijnë edhe ne. Për ku ka nevojë?

— Gjer te rruga automobilistike.

Erdhën edhe të tjerë.

U nisën shumë vetë. Shoferi ecte përpara, traktoristi pas tij. Prapa tyre vinte Sherifi, të shtatë himarjotët dhe të tjerët.

Sherifi ktheu kokën dhe tha:

— Ju, himarjotët, qenki veshur si për plazh. Shkoni në depo të merrni kokore, çizme dhe pelice. Morët vesh? Apo doni të hani ndonjë plevit? Do t'ju jap një vërtetim. Jo, jo. Më mirë po vi me ju, kur të kthehem.

Duke biseduar, dolën në rrugën automobilistike. Traktoristi hipi mbi traktor dhe e ndezi. Traktori çante përpara. Ata shkonin pas. Më në fund u duk edhe maqina te një kthesë e fortë. Ish batuar dhe kish zënë rrugën kryq. Disa trarë kishin rënë dhe ishin rrukullisur poshtë xhadesë.

Dëgjoheshin borie që u binin me inat. Pas maqinës së rrëzuar ishin radhitur katër maqina të

tjera të ngarkuara me tulla. Kur panë traktorin, shoferët zbritën dhe u afruan.

— Shyqyr që erdhët. Kemi një orë që presim.

— Jo një orë... Zbrit pak se të panë, — tha traktoristi, duke i shkelur syrin atij që foli.

Lidhën kavon dhe traktori bëri përpara, Maqina lëvizi dhe u fut në rrugë. Ende nuk ish ndezur.

Himarjotët po mblidhnin trarët që kishin rënë. Po i grumbullonin afër maqinës. Kur po sillnin trarët e fundit, kavua që lidhte traktorin me maqinën doli nga ganxha. Maqina nisi të rrëshqasë nëpër akull, duke ecur sëprapthi, megjithëse shoferi i kish shkelur frenat gjer në fund. Dikush që ishte prapa maqinës filloi të ikë me vrap. Nuk bëri as dy hapa dhe u rrëzua në mes të rrugës. Maqina po i afrohej. Edhe pak dhe mbi njeriu e rrëzuar do të kalonin rrotat.

Stefani që ishte pas tij, thirri:

— Vini supet maqinës!

Dhe u sul i pari. Mbështeti këmbët në një gropë dhe vuri supin te sponti i prapmë. Ndjeu një dhëmbje të madhe. Pastaj nisi ta shtyjë me këmbë të rrëzuarin. Ai u rrukullis disa herë nëpër akull dhe qendroi në anë të rrugës.

Pas Stefanit i vunë supet edhe të tjerët. Maqina nuk po rrëshqiste më si më parë. Dy himarjotë, trarin e fundit që po mbartnin, e vendosën pas rrotave të prapme. Pastaj e mbajtën me të gjitha forcat. Ca nga supet që kishin vënë njerëzit, ca nga trari, ca nga frenat që kish vënë shoferi, maqina ndaloi fare.

Traktoristi me shoferin e lidhën përsëri ka-

von dhe shkuan te ai që ish rrëzuar. E ngritën. Rreth e rrotull tij shkuan edhe të tjerët. Ish një shofer nga ata që sillnin tulla. Në ballë kish pak gjak. Ish vrarë edhe në gjunjë e në bërryla, po nuk u ankua. Ja lanë gjakun dhe filluan t'i lëvizin këmbët e duart. Një shofer solli shishen me konjak dhe i dha të pijë. I rrëzuari e mori veten dhe pa përreth.

— Kush më shtyu?

Disa treguan Stefanin me gisht dhe thanë:

— Ky!

— Ti më ke shpëtuar jetën...

Vrapoi. Ju hodh në qafë dhe e shtërngoi fort. Faqet e Stefanit u njomën nga lotët. Shoferi po qante. Edhe Stefanit i vinte për të qarë. I dhimbte supi që i shtërngoi shoferi, kur ju hodh në krahë. E kish vrarë te sponti i maqinës. Kushedi, mund të kish thyer edhe ndonjë kockë. Kur mbështeti supin te sponti, ju duk se diçka kërciti. Ndofta ash tu i qe dukur.

Shoferi e shtërngonte ende dhe thërriste!

— Ti ke bërë një heroizëm! Dëgjon, apo jo? Ku janë ata gazetarët? Për ty duhet të shkruajnë patjetër.

Shoferi e pyeste. Stefani e shikonte pak si i habitur dhe mendonte.

«E c'gjë kam bërë unë që të më marrë gazeta? Heronj janë Lumja që shkoi e plagosur në hekurudhë, babai i Lutfies që bredh me fener në dorë në të katër anët e fshatit dhe ka mposhtur dhimbjen për humbjen e gruas e të djalit... Ata janë heronj». VIA

rrugët. Më pasqyri dai ëpërisht që nisurida edhe nov
dijt del. Nëvegj është mësuar që jep histori e dësh
dixgjancët. Në këtij rast qëllia është tashmë që
duhet që shkronja e këtij rast qëllia të jetë dalë së paktë
qëllivël. I't qëllit qëndron këtij rast. Në këtij rast
sot nuk mundet qëllit qëndron këtij rast. Në këtij rast
edhe nuk mundet qëllit qëndron këtij rast.

IV

HYSENI DOREZOHET...

ATA u kthyen me maqinë gjer te rruga që shkonte për në Ostush. Aty zbritën dhe u nisën për në «shtëpinë e të gjithëve». Kështu e quajtën himarjotët shtëpinë ku fjetën atë natë. Bashkë me ta ishte edhe Sherifi. Traktoristi nuk u kthye më, megjithëse nuk kish fjetur fare atë natë.

Shkuan drejt e në magazinën e veshmbathjes. Sherifi hodhi një firmë dhe të shtatë himarjotët morën kokore, çizme dhe goxhupë të ngrohtë. Morën edhe për Voisavën e për Pandoren.

— Dhe tani, — tha Sherifi, — në frontin e punës.

— Ku do të punojmë?

— Te shtëpia e Hysen Lulës. E shikoni atë shtëpinë që është rrëzuar krejt?

— Aty ka shumë të rrëzuar...

— Atë që ka një tra, si direk vaporit në mes. Aty do të shkoni. Keni edhe shokë të tjerë: nga

Shkodra, nga Elbasani, nga Tirana. Ata të Tiranës janë punëtorë të «21 dhjetorit». Ka edhe nga krahina të tjera. Nga gjithë Shqipëria. Hajt, mirupafshim.

— Mirupafshim!

U nisën të gjithë bashkë. Te shtëpia e Myftarit ndalën. Stefani thirri:

— Zgjodi ato shoqet, o Myftar, se vajti vonë!

Në derë dolën Voisava me Pandorën. Dolën edhe fëmijët e Myftarit.

— Myftari me të shoqen kanë dalë që në pikë të sabahut. E shoqja punon në arë, Myftari po ngre shtëpi.

— Gati jeni ju?

— Erdhëm.

U bashkuau edhe ato me grupin. Shkuau drejt e në shtëpinë e Hysen Lulës. Shtëpi i thënçin, se aty s'kish mbetur asgjë më këmbë. Çatia ish fundosur brenda në bodrum. Muret ishin bërë rrafsh me tokën. Qerpiçin e kish prishur ngrica dhe bora. Ishin bërë prapë baltë. Asgjë s'kish mbetur më këmbë nga shtëpia, vec atij trarit që u tregoi Sherifi.

Shtëpia e xha Hysenit do të bëhej krejt e re. Do të ndërtohej ca më poshtë, aty ku kish një copë shesh të vogël. Aty do të ndërtoheshin edhe shtëpi të tjera, të reja krejt. Këta njerëz, që kishin qenë larg njeri tjetrit për shekuj me radhë, tani do t'i kishin shtëpitë afër e afër. Edhe dritaret do t'i kishin më të mëdha që të hynin dielli e ajri i freskët. Njeriu ka shumë nevojë për dritë dhe për ajër. Sidomos për shokë e miq.

Po xha Hyseni nuk donte t'i lëvizte themelet e shtëpisë. Ai ngulte këmbë si mushka:

— Ja këtu ku ka qenë, ja nuk dua shtëpi fare!
Të tërë e pyesnin:

— Po pse, more xha Hysen?
Ai përgjigjej me pak fjalë:

— Këtu ma kanë lënë të parët.

Po xha Hyseni e kish hallin gjetiu. Veç nuk tregonte. Brigadieri, një murator i «21 dhjetorit» tha:

— Ne kemi urdhër ta ndërtojmë te sheshi. Ti po deshe futu në të, po deshe rri jashtë në borë. Vendi është piketuár. Po çuditem me ty, mor vlla: të falin një gomar dhe e shikon nga dhëmbët? Kështu themi ne nga anët tona.

Një marangoz nga Elbasani pyeti Myftarin:
— Pse nuk do xha Hyseni?

Myftari u përtyp. Në fillim nuk desh të tregonte. Po pastaj tregoi.

Në shesh kish qenë një tyrbe. Kish qenë aty ku do të ngriheshin muret e shtëpisë së Hysenit. Prandaj nuk donte. Këtu qendronte gjithë puna. Marangozi nga Elbasani tha:

— Ka të drejtë xha Hyseni... Aty ku janë themelet ka qenë tyrbe. Si mund të ngrihen muret e shtëpisë mbi ato të tyrbes? E lejon zoti një gjë të tillë?

— Mos thuaj zoti, shok, po ish zoti!

Qeshën të tërë. Vetëm xha Hyseni heshtte. Stefani ju afrua. Ju afrua edhe brigadieri i «21 dhjetorit». U afroan edhe të tjerë. E vunë në mes.

— Me të vërtetë e ke, o xha Hysen?

Xha Hyseni u kthye nga bashkëfshatarët e tij:

— Një nga ju më ka prerë në besë! Vetëm ju e dinit ç'ka qenë këtu...

Bashkëfshatarët heshtën.

— Akoma me të vjetrën ti, o xha Hysen?

— Ku ka tyrbe e zot!

Xha Hyseni u kthye nga ai që foli në fund.

— Për ty mbasë s'ka, po pér mua... Ky tërmëti nga na erdhi?

— Nga natyra.

— Mbasë... Po pér mua...

Xha Hyseni nuk e çonte gjer në fund fjalën.

Stefani e vazhdoi mendimin që xha Hyseni e la përgjysmë:

— E di si thua ti, xha Hysen? tërmëtin na e dërgoi zoti. Mirë, po ta pranojmë. Me siguri ti mendon se na e dërgoi meqë i mbyllëm kishat e xhamitë. Edhe pse na e dërgoi po fa pranojmë. Pra, zoti mori hakun.

— Nuk e di...

— O po thuaje troç, se nuk të vret njeri. Perëndia është zemëruar me ne të rinjtë dhe na goditi.

Marangozi nga Elbasani tha:

— Po pse të godiste këta të Dibrës? Të parët e filluan të rinjtë e Durrësit. Ata të kish goditur.

Një tjetër bëri shaka:

— Do të ketë qenë i dehur zoti dhe ngatërroi rrëthet. Me D fillon Durrësi, me D fillon edhe Dibra. Ja futi Roma pér Toma.

Qeshën të gjithë. Qeshi edhe xha Hyseni, po padashur.

— Folë, xha Hysen, pse nuk flet?

— Më morët shpirtin: një me njëqind!

Dikush tha:

— Xha Hyseni duhet demaskuar para fshatit, se ka mbeturina.

Stefani i hodhi dorën në sup.

— Xha Hysen. Po të pyes me zemër në dorë. Nuk e kam me hile. Dua të më përgjigjesh si burrat, ama. Hidhi sytë matanë. Ja vija e kufirit. Ja edhe Koxhaku, fshat i Kosovës që e kemi kundruall. Sheh gjer atje, apo jo?

— Shoh mirë, edhe pse jam plak.

— Edhe aty ka shtëpi të rrëzuara, apo jo? Po dy xhamitë i sheh? Edhe ato janë rrëzuar. Kush i rrëzoi ato? Titua? Jo. I rrëzoi tërmeti. Pra i rrëzoi zoti. Pse i rrëzoi? Hë de, folë! Pse i rrëzoi shtëpitë e tij në «tokë zoti»? Pse e mori hakun edhe atje, ku perëndisë nuk i kanë lëvizur asnje qime, po, përkundrazi, e mbajnë me të mirë, se u duhet pér të gënjer popullin?

Xha Hyseni heshtte. Pastaj shikoi nga Koxhaku dhe tundi kokën. Po vriste mendjen:

«Vërtet, pse u prishën xhamitë në Koxhak? Atje rinia nuk i ka myllur kishat e xhamitë. Atëhere, pse i goditi zoti me tërmet?.. Sa i zgjuar ky djalë! Më lidhi me fjalë. Ku i vajti mendja shejtanit! Me një nyje më lidhi. Hajde përgjigju tani. Po zot ka, ama... Mbase nuk quhet zot, po ndryshe...»

Stefani ja ndërpree mendimet:

— Re në të thella, xha Hysen...

— Më ke zënë ngushtë. Ju rinia të lidhni me fjalë!

— E, si thua, ta fillojmë shtëpinë?

— Bëni si të doni...

— U dorëzua, — tha marangozi nga Elbasani.

— Nuk është dorëzuar, — tha brigadjeri i «21 dhjetorit».

— Nuk dorëzohen lehtë fetarët. Bëri vetëm një lëshim, — shtoi Stefani.

Genti tha:

— Sidoqoftë kjo është një fitore për ne. Se ne nuk kemi ardhur vetëm për të ndërtuar shtëpitë. Bashkë me shtëpitë ndreqim edhe ndërgjegjet tona.

Shumica zbritën te sheshi. Të tjerët mbetën për të nxjerrë trarët e dërrasat nga shtëpia e rrëzuar. Sheshi ish mbuluar me borë. Kish mbi gjysmë metër. Bora kish ngrirë. Akull i përzier me baltë. Erërat që frynin ditë e natë, sidomos natën, e kishin bërë kallkan.

Disa nisën të gërmojnë me kazmë. Po ku hynte kazma në akull! Kthehej pa gërvishtur asnjë majë thoi.

— Duhet të punojmë me qysqi.

— Ku t'i gjejmë se?

— As qysqitë s'bëjnë punë këtu.

— Po si të bëjmë?

Nga lart po zbriste brigadieri i «21 dhjetorit». U afrua, pa akullin dhe tha:

— O burra, dru! Çfarë të jenë: të holla, të trasha. Do t'i vendosim rrëth e rrotull themelit.

Do t'u vemë flakën dhe akulli do të fillojë të shkrijë.

Të gjithë u shpërndanë. Pas pak nisën të kthehen me barrë drush, me trarë e dhoga të kalbura. I pari u kthye Stefani. Kish marrë një barrë me dru të trasha te shtëpia e Myftarit. I lëshoi përtokë dhe vuri dorën te supi. Ndjeu një të therur. Sikur e goditi dikush me thikë. Brigadieri i «21 dhjetorit» e pa dhe i shkoi pranë.

— U vrave?

— Jo. Më duket se jam vrarë në mëngjez, kur lëvizëm maqinën në rrugë.

Brigadieri i «21 dhjetorit» i hoqi goxhupin, i zbërtheu këmishën dhe i shikoi supin. E kish të nxirë në një copë vend.

— Qenke shembur keq... O Sokol!

Një djalë i ri, veshur me tuta, lëshoi barrën e druve dhe sakaq u gjend përpara brigadierit.

— Urdhëro!

— Lyeja me jodio supin. Futuni te zyra e shtabit.

Sokoli me Stefanin shkuat te zyra e shtabit. Aty s'kish njeri. Zilja e telefonit po binte pa pushim. Në çast erdhi Sherifi. Kapi mikrotelefonin dhe herë fliste me njeriun matanë telit e herë me Stefanin.

— Po, po. I morëm. Je plagosur? Ke qysh në mëngjez dhe nuk the gjë?.. S'e kam me ty, jo. Faleminderit.

E mbylli telefonin.

— Si, more, u vrave dhe s'the gjë? Shpejt

të gjejmë doktorin. Ti shok, — dhe ju drejtua Sokolit, — mbaro punë dhe shko gjej doktorin. More vesh?

Sokoli ja leu supin me jodio dhe vrapiqë ja-shtë. Pas tij u nis edhe Stefani.

— Shoku Sherif. Po erdhë doktori, le të kthehet nga shtëpia e xha Hysenit. Atje te sheshi do të jemi.

Dhe iku. Sherifi i thirri që të ndalonte, po Stefani bëri sikur nuk e dëgjoi.

Mbi akull kishin ndezur zjarre. Flakët dhe tymi ngriheshin lart. Poshtë rridhnin ujrat që shkrinin. Në mes të akullit hapeshin gropë dhe kanale. Zjarri binte poshtë e më poshtë, gjersa takonte në tokë. Kaloi një orë, ndofta edhe dy. Pastaj e shuan zjarrin vetë. Nisën të pastrojnë vendin nga drurët e djegur. Pastruan me duar e me lopata borën, akullin e shkrirë, hirin. Kur e pastruan mirë vendin, ndezën prapë zjarr në kanelat e hapura. Duhet të shkrinte edhe toka, se kish ngrirë. Pastaj morën kazmat. Kazma morën muratorët, marangozët, punëtorët dhe fshatarët. Burrë e gra.

Dhe kazmat ranë në tokë. Po toka s'kish shkrirë ende mirë. Mezi shkëputëj ndonjë copë baltë e zezë.

Xha Hyseni rrinte duarkryq para themeleve që po hapeshin dhe shikonte. Nga sytë i rridhnin lot.

Pse qante xha Hyseni? Mos vallë për tyrbën që po i nxirrin themelët? Apo nga gëzimi se po i ndërtonin shtëpi të re?

E mbytën kujtimet. Sa kujtime ju ngjallën atë çast! Katrori i bardhë që mbeti në mes të themeleve të zeza, ju duk si një arkë e madhe. Vullnetarët e specialistët, duke hapur themelet, e shkallmuani me kazma kapakun e arkës. Prej an-dej nuk doli hoxha i tyrbes. As zoti. Doli tërmeti që ra në vitin 1942. Ish një qenie e madhe. Ish një qenie e tmershme. E neveritshme. Si përbindshit e përrallave.

Tërmeti kish dalë nga dheu, kishte lëvizur supet e tij dhe i kishte rrëzuar shtëpinë duke i bërë rrafsh me tokën. Dhe njerëzit kishin ngelur jashtë. Jashtë kishte mbetur edhe xha Hyseni vëtë, me gruan dhe me fëmijët. Jashtë, në mes të katër rrugëve...

V

GROPA ME KASHTË


KËTË histori xha Hyseni e tregoi më vonë. E tregoi shtatë ditë pasi u hapën themelat e shtëpisë, aty te sheshi, ku kish qenë një tyrbe.

Në dhomat e shtëpisë së re ishin ulur gjithë ata njerëz. Në krye rrinte brigadier i «21 dhjetorit». Si e kish emrin? Asnjë nuk ja dinte. Atij vazhdimisht i thërrisinin brigadier. Kudo që kish ndërtuar shtëpi, në të katër anët e vendit, atij i thërrisinin brigadier. Edhe vetë drejtori i kantierit brigadier i thërriste.

Në këndin tjetër rrinte Pandora. Asaj ja lëshoi vendin një oficer.

Aty, rretherrotull, ishin edhe marangozi nga Elbasani, ai korçari që i binte kitarës, një oficer, dy ushtarë dhe plot të tjerë. Ish edhe Stefani.

Supin tani e kish më mirë. Nuk ndjente më dhëmbje. Doktori e kish parë disa herë. I bënte masazhe, e fërkonte me alkool. Çdo natë i bënte



banja me ujë të nxehjtë në shtëpinë e Myftarit. Dhe tani, pas shtatë ditësh, e kish më mirë.

Xha Hyseni e shtroi atë natë që hvri në shtëpinë e re. Dhe thirri gjithë ata njerëz. Po nuk bëri ndonjë gjë të madhe. Secili i kish marrë me vete ushqimet. Ai vuri vetëm rakinë, zjarrin që digjej në vatër dhe zemrën. Zjarr e zemër. Këto duhen në dimër. Këto duheshin në shtëpinë e re, ku ishte ulur këmbëkryq gjithë Republika.

Kur u ngroh shtëpia dhe njerëzit, xha Hyseni kish dëshirë të fliste dhe të tjerët ta dëgjonin. Donte që ta dëgjonin njerëzit dhe muret e reja. Ta dëgjonin të katër dhomat, dyshemeja, tavani. Se as ata që e rrethonin, as shtëpia e re nuk e dinin historinë e tij. Jo historinë e tij, po të shumë e shumë të tjerëve.

Xha Hyseni nuk mund të rrinte pa e treguar atë histori. E kish mbajtur në kraharorin e tij dhe donte ta nxirrte jashtë. Ai nuk mund ta ndalonte. Atë histori duhej ta dëgjonin të gjithë. Ata që mbetën pa shtëpi nga tërmeti i dhjetorit dhe ata që vrapanuan nga çdo anë për të ndihmuar vëlle-zërit. Atë histori duhej ta dëgjonte gjithë Shqipëria... Pastaj, si ta dëgjonin mirë e mirë, të bënnin krahasime. Të krahasonin dy tërmetet. Jo tërmetet. Të krahasonin tërmetet dhe njerëzit, tërmetet dhe kohrat, tërmetet dhe epokat.

Edhe atëhere ra tërmet. Tërmet si ky që ra tani. U prishën shtëpi, u vranë njerëz. Mbetën njerëzit pa strehë, pa shtresë e mbulesë. Mbetën edhe pa bukë. Asnjë nuk vrapi për në Dibër. Madje as nuk mendoi për Dibrën. As që dëgjuan

gjë pér Dibrën. Dibranët nisën tē mendojnë pér vete, pér fëmijët e tyre, pér shtëpitë e tyre. Disa ikën. Ikën dhe morën dheun. Shtëpitë nuk i ndërttonin dot. Ku ta futnin kokën? Tokë s'kishin. Ba-gëti s'kishin. Shtëpi s'kishin. Atëhere morën rrugët. Rrugët ishin tē gjata, pa fund. Ku mbaronin rrugët? Në Stamboll, në Australi, në tē katër anët e botës. Në këto rrugë ecën dibranët. Dhe nuk u kthyen më... Ku janë? Janë a s'janë? Ah, sikur tē vinin tanë dhe tē shikonin sa shpejt po ndërtohen shtëpitë. Ku janë vëllezërit që ikën më 1942? Janë a s'janë? Sa keq që nuk e dëgjojnë zërin e xha Hysenit që tregon historinë e tij dhe historinë e tyre.

Edhe xha Hysenit i ra shtëpia. Ju bë njësh me tokën. Si në tërmetin e këtij dhjetori. Si ta ndërtonte? Me ç'farë? Ai s'kish asgjë. Kish pesë fëmijë tē vegjël, gruan dhe veten. Kish dhe një copë arë. Të shiste arën dhe tē ndërtonte shtëpinë? Po ç'do tē hanin fëmijët? Do tē vdisnin urie. Të shiste fëmijët? Asnjë nuk i blinte fëmijët. Pastaj, ku ka prind që shet fëmijët? Po çfarë tē bënte atëhere? Të ikte? Ku tē shkonte? Kudo ishte njëlloj... Pastaj i dhimsej ara, muret e rrëzuara, rrugët, fshati, njerëzit. Të gjitha i dhimseshin.

Fëmijët luanin në oborr. Ata nuk dinin asgjë. Ditën luanin. Natën flinin. Flinin në gropën që kish hapur xha Hyseni në oborr. Ish një gropë nga dy metra e thellë. Poshtë shtronte kashtë xha Hyseni. Shumë kashtë. Anash vinte përsëri kashtë. Pastaj fuste fëmijët brenda. Dhe i mbulonte me kashtë. Ata flinin. Në kashtë flihet mirë. Nuk

ngrin. Nuk ke tē ftohtë. Në mëngjez, fëmijët del-nin me fije kashtë në flokë, në rrobe e kudo. Dhe prapë luanin.

Po nuk flihet gjithmonë në gropën me kash-të. Duhet një kasolle sa pér tē futur kokën, sa pér tē ndezur një zjarr. Po si ta ndërtonte?

Xha Hyseni kish dëgjuar se mëkëmbësi i mbretit në Shqipëri, Jakomoni, kish dërguar njëzet maqina me material ndërtimi, pér bajraktarët e dëmtuar nga tërmeti. Materialet kishin ardhur. Kish marrë edhe Xhemil Halia, bajraktari i Ostushit. Kish marrë tjegulla, tulla, lëndë druri. Po çfarë i donte Xhemil Halia gjithë ato materiale? Atë nuk e kish dëmtuar tërmeti. Shtëpitë i kish më këmbë dhe tē paprekura. Edhe shtëpitë, edhe hauret, edhe koçekët me misër. Edhe farefisi i tij nuk ishin dëmtuar. Po sikur t'i kërkonte ndihmë Xhemil Halisë?

Dhe i shkoi drejt e në shtëpi. Xhemil Halisë i erdhi mirë kur e pa në derë. Se xha Hyseni ish koki më vete. Nuk kish shkelur kurrë në derën e bajraktarit. As pér mirë e as pér keq. Edhe ishin ngrënë pér atë copën e arës që kish afër tokave tē Xhemil Halisë. Bajraktari kish dashur t'ja merrte me dredhi disa herë, po s'arriti dot.

Sa e pa, Xhemil Halia e kuptoi ku e kish hallin xha Hyseni. E ndjeu se i erdhi gjahu në shteg.

— E di pse ke ardhur, — i tha. — Folë sa tē duhen dhe çfarë tē duhet. Mos u tut!

Xha Hyseni u drodh. Kur u bë qengj ujku? Pse e priti kështu? Në buzëqeshjen e tij fshihej

një mendim i keq. Xha Hyseni e shikonte mirë. Tak! ja bëri zemra dhe mendja i shkoi te toka. Pas tokës i dolën fëmijët në gropën me kashtë... .

— Ca me lekë në dorë, se kam pak, — tha xha Hyseni. — Të tjerat më vonë.

— Për një vit, — tha Xhemili dhe shtërngoi brezin. U tund koburja me dorezë fildishi.

«Pse e tregoi koburen?»

Xha Hyseni vriste mendjen... Në fund kërkoi t'i jepnin aq tjezugulla, aq lëndë e aq tulla, sa i duheshin.

Bajraktari i tha njërit që kishte afër:

— Bëje llogarinë.

Tjetri e bëri llogarinë. Pasi dëgjoi shumën, xha Hyseni tha:

— Shumë është, o bajraktar...

— Ulja njëzet përqind, — urdhëroi bajraktari.

Tjetri e uli njëzet përqind. Xha Hyseni pranoi. Vuri gishtin në dëftesë.

Qysh atë ditë i mori materialet. I ngarkoi në krahë, bashkë me të shoqen. Mbaj ai, e mbaj gruaja. Mbanin edhe fëmijët. Mbanin tulla e tjezugulla. E ndihmuani edhe nga dy të afërm. Ju deshën njëzet ditë që t'i grumbullonte afër shtëpisë së vjetër materialet.

Pastaj filloi ndërtimi. Do të ndërtonte vetëm një dhomë. Asgjë më shumë. Dhe e ndërtoi. Të ulët, pa tavan, me dritare të vogla... Sa për t'u futur brenda. Dhe u fut. U ndez zjarri në vatër. Shpëtuan fëmijët nga të ftohtit, nga gropë me

kashtë. Po nuk shpëtuan nga bajraktari. Ai u rrin-te si shpatë mbi kokë: U dha shtëpinë dhe donte t'u merrte tokën. U dha zjarrin dhe donte t'u merrte bukën.

Xhemil Halia donte borxhin. E donte bajraktari, po ku ta gjente xha Hyseni? S'mblodhi dot as gjysmën për një vit. Ishin shumë pare. Ku të merrte borxh për të shlyer borxhin e bajraktarit? Të gjithë ishin keq. Kish edhe më keq se xha Hyseni.

Erdhën njerëzit e bajraktarit në shtëpi. Erdhi edhe vetë bajraktari. Pastaj filluan vajtje ardhjet në gjyq. I la të gjitha ç'kish kursyer. I mbetën vetëm dy udhë: ja të dilte në rrugë të madhe, në mes të dimrit, ja të jepte tokën. Shtëpinë ose tokën. Rrugë tjetër s'kish. Dha tokën. Nuk e dha, por ja morën. Ja vodhën. Ja grabitën. Bashkë me tokën, bajraktari donte t'i merrte edhe shpirtin.

Kështu mbeti pa tokë. Mbeti pa bukë. Dhe mori rrugët e Shqipërisë. Punonte me bel, priste dru. Zérin e tij e dëgjoje nëpër rrugët e fshatrave e të qyteteve. Ai zë thërriste:

— Dru me pre!

— Tokë me punue!

Ishte zëri i xha Hysenit.

Këtë zë nuk e dëgjuam më vonë, kur xha Hyseni e mori prapë tokën, kur e morën gjithë fshatarët e Shqipërisë. Më 17 nëndor 1946. Ja dha reforma agrare.

Punoi tokën e tij, fëmijët ju rritën dhe pastaj i shtoi dhomat një e nga një. E bëri shtëpinë

me dy kate, me katër dhoma. Ja, si kjo që i ndërtuan vullnetarët e specialistët. Për ta ngritur ju deshën njëzet vjet. Njëzet vjet djersë. Dhe punën e njëzet vjetëve e rrafshoi tërmeti në pak sekonda. Djersën e njëzet vjetëve e thithi përbindshi në çast. Pse i thonë tërmet? Ai është përbindësh, djersëpirës, gjakpirës. Ai është vëlla i luftës.

Tani shtëpia ju ndërtua për shtatë ditë. Në shtatë ditë ndërtoheshin nëpër përralla shtëpitë, jo në jetë. Mirëpo u ndërtuakan edhe në jetë! Këtë gjë nuk e dinte xha Hyseni. Po e mësoi. E pa me sy. E mësuan të gjithë. E panë të gjithë me sy. Madje i ndërtuan vetë.

Shtëpinë e tij e ndërtoi gjithë Shqipëria. Atëhere e ndërtoi vetë, për njëzet vjet. Tani e ndërtoi me shokë për shtatë ditë. Njëzet vjet dhe shtatë ditë. Ai vetëm dhe gjithë Shqipëria! Me borxhe dhe falas! Me bajraktar mbi kokë dhe me shokë përreth. Pa tokë e në kasolle dhe me tokë e në pallat! Ç'krahasime!

Xha Hyseni ngriti kokën dhe thirri:

— Me fund! Ta pimë për partinë!

Dhe e piu. Pastaj qeshi. U ngrit më këmbë. Nuk u ngrit ai, po një copë shkëmbi. Dhe thirri prapë duke përplasur këmbët:

— Poshtë bajraktarët kudo në botë!

Stefani e shikonte. Nuk e shikonte, po e përpinte. Xha Hyseni nuk mbahej dot. Në shpirtin e tij zienin urrejtja dhe dashuria. Urrejtja për të kaluarën dhe dashuria për të tashmen. Urrejtje dhe dashuri! Sa të forta janë këto ndjenja. Stefani

e shikonte plakun. Nuk e shikonte, po e përpinte. Ç'njeri që ish xha Hyseni! Tek ky njeri ishin përzier diçka e mirë dhe diçka e keqe. Të keqen e kish nga e kaluara, nga bajraktari, nga tyrbja, nga ho-xha. Të mirën e kish nga çlirimi, nga reforma ag-rare, nga kooperativa. Stefani duhej ta mësonte mirë historinë e tij. Ish një histori e dhimbshme. Ish një histori tragjike. Ish një histori si e gjithë malësorëve të tjerë.

VI

USHTARI NGA DUKAGJINI

NË çadra u kthyen shumë vonë. Tej, në një shtëpi që sapo i ishin ngritur muret, po punonin ushtarët. Në shtyllat e skelave ndrisnin poçat e elektrikut. Aty afër punonte një motor i vogël. Herëpashere vinte një zë i humbur:

— Ujin se u ftoh llaçi!

Stefani ecte dhe mendonte:

«Sa mirë do të qe sikur fshati të kishte drita. Do të punonim edhe natën. Dhe shtëpitë do të mbaroheshin më shpejt. Fëmijët do të mblidheshin rrëth vatrës. Në vatra do të ndizeshin zjarre. Nga oxhakët do të dilte tymi... Ose, fundi, të kishim disa motorë të vegjël, si ai që kanë ushtarët... Po sikur ta bëjmë ndryshe? T'i mbledhim gjithë llampat me vajguri që ka fshati dhe t'i varim nëpër trarët e skelave. Atëherë mund të punojmë edhe natën. Le të rrinë disa ditë pa llamba njerëzit. Le

të bëjnë si të bëjnë. Duhet t'ua them shokëve të shtabit. Fshatarët do t'i japid llambat me gjithë qejf. .»

Dhe u kthye nga shokët, u tregoi ç'mendonte, pastaj i pyeti:

— E, si thoni ju? E kam mirë, apo jo?

Ata e pëlqyen mendimin e tij.

Pandora tha:

— Të shkojmë qysh tani në shtab!

Te zyra e shtabit bëhej mbledhje. Dikush fliste me zë të lartë në telefon. Jashtë dëgjoheshin copa frazash dhe shifra të shkëputura. Nga zëri dukej se fliste Sherifi.

Ai që rrinte te porta u tha:

— Duhet të prisni sa të mbarojnë.

Ata qëndruan në koridor, të gjithë bashkë. Pritën shumë. Ndofta një orë. Ishin bërë akull. Stefani nuk ndjente në kish gishtrinj në këmbë, apo jo. Shalli prej pambuku që mbante në qafë, i kish ngrirë fare. Dukej si një copë dhogë e përkulur. Flokët i qenë bërë si shkopinj të akullt. Sa ftohtë që kish! Me siguri Pandora me Voisavën mërdhinin më shumë. Po asnjë nuk tha: «Mërdhi». As vajzat, as djemtë. Asnjë nuk tha: «Po iki». As djemtë, as vajzat. Rrinin aty dhe prisnin.

Stefani mendonte:

«Më mirë të punonim. Duke punuar, ngrohesh, se lëviz krahët, lëviz muskujt, lëviz gjithë trupin. Lëviz edhe gjaku. Dhe ngrohesh».

Dera e zyrës u hap. Dolën njerëz me jaka të ngritura. Vetëm njëri mbeti brenda. Ndofta do të

qe dezhurni. Himarjotët u futën dhe dalngadalë filluan të shkrifen. Sherifi i ftoi të ulen. Ata u afruan te soba dhe Stefani nisi të flasë.

Nga flokët po u binin pika uji. Po shkrinte akulli. Ndonjë pikë hynte nëpër boshllëkun që kri-jonte qafa me jakën dhe zbriste poshtë kurrizit. Atëhere u rrëqet hej trupi edhe më shumë e u kalonte një e dridhur që nga majë e kokës, gjer te gishtrinjtë e këmbëve.

Nuk qëndruan gjatë. Biseda qe e shkurtër. Sherifi e pëlqeu mendimin e tyre dhe shtoi:

— Qysh nesër mbrëma do t'i mbledhim. Dhe nuk do të mbledhim vetëm ato. Do të marrim edhe llambat që ka dyqani i konsumit. Më duket se ka nja njëzet copë, në mos më shumë.

— Sa bëhen kështu?

— Rreth njëqind llamba.

— Me kaq llamba mund të punohet në dhjetë objekte. Dy te llaçi, një te tullat, tre në shkallët që të cojnë në çati dhe të tjerat në skela. Po t'i varim nëpër shtylla, e bëjnë natën ditë.

Ikën të kënaqur. Të ftohit e harruan fare.

Të nesërmen do të punohej edhe natën. Sa bukur do të dukej fshati! Njëqind llamba me vajguri të vendosura nëpër shtylla. Do t'i shikonin që matanë kufirit dhe kushedi ç'do të mendonin. Tani mbasse nuk do të mendonin kushedi se çfarë... Po pas dy tri javëve, kur ta shikonin fshatin të rindërtuar, ç'do të thoshin vallë? Po pas dy vjetëve, ndofta edhe pas një viti, kur ta shikonin fshatin plot me llamba elektriku, ç'do të thoshin vallë? Ti-

tistët do të tërboheshin dhe do të çireshin:

— Kjo dritë po na verbon!

Ndërsa kosovarët do të thoshin me vete:

— Vëllezërit tanë, matanë kufirit, kanë lindur me këmishë! Sikur ta kishim edhe ne fatin e *tyre*...

Dikush po ecte vetëm nëpër borë. Stefani i thirri:

— S'ka rrugë andej, o shok! Dil majtas.

Ai që vinte vetëm bëri pak majtas dhe doli në rrugë. U afrua pranë himarjotëve.

— Mirsejugjej, o shokë!

— Mirseerdhe!

Stefani e shikoi që nga koka në këmbë. Flökët i kish të prera shkurt. Qe veshur me një xhaketë dhe me një palë pantallona ushtarësh ngjyrë kaki. Në këmbë kish një palë këpucë të vjetra, me qafë, ndërsa në duar doreza leshi. Ngjante si ushtar i liruar. Në krah kish hedhur një çantë prej doku.

— Nga kështu, o shok?

— Nga ushtria... Ngriva...

I dridhej mjekra kur fliste.

E morën për krahësh dhe e futën në çadër. Soba digjej në mes të çadrës. Genti futi edhe dru të tjera. Tubat u skuqën. Ai që dukej si ushtar i liruar, u shtri në krevatin e Stefanit dhe mezi i dëgjohej frymëmarrja. I hodhën nja katër batanie. Stefani nxori shishen me raki dhe nisi ta fërkojë në damarët e qafës. Po e fërkonin edhe të tjerët, në duar e në këmbë. I dhanë të pijë edhe ponç.

Kur u përmend, Stefani i tha:

— Erdhe si në dasmë, o shok... Kështu erdhëm edhe ne nga Himara. Po hajt se nesër do të rregullohesh. Kështu u rregulluam edhe ne... Po nga të kemi?

— Nga Dukagjini. Kam qenë ushtar në Durrës. Dje u lirova.

Dukagjinasi ish i ri. Nuk ish më shumë se njëzet e dy vjeç. Trupgjatë, me nofulla të dala jashtë shumë, me ballë të gjerë dhe pak i vrejtur. Si ata malësorët që shohim nëpër pikturat e Danish Jukniut. Në fytyrë e në duar ish pak si i përzhitur nga zjarri.

Ai që ishte me të vërtetë ushtar i liruar, tregoi pak gjëra ngajeta e tij. Madje tregoi vetëm përdy ditë të jetës së tij. Sidomos tregoi përditën e fundit. Për atë ditë që sapo kish perënduar.

Kish qenë ushtar në Durrës. Një ushtar i thjeshtë, si shumë të tjerë. Kryente shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Mbante një dekoratë. Ja kishin dhënë për trimëri. Ku e kish treguar trimërinë ky djalosh nga Dukagjini? Në luftë? Në cilën luftë?

Trimërinë e kish treguar në punë. Jo me pushkë, po me pompën e zjarrfiksit. Ai kish qenë ushtar bashkë me Ismail Mehmetin.

Ismaili ish nga Llakatundi i Vlorës. Edhe ai ish ushtar i thjeshtë si ky dukagjinasi. Edhe Ismaili kish luftuar me pompën e zjarrfiksit. Dhe, përtë shpëtuar pasurinë, kish dhënë jetën. Ish djegur. Trupi i tij ish bërë pishtar për ushtarin nga Duka-

gjini. Për të gjithë ushtarët tanë. Për të gjithë pollin. Ish djegur si Muhamet Shehu e Myrteza Kepi në Linas.

Stefani e ndërpree tregimin e ushtarit të liruar.

— Sa interesante, more shoku Mark! A e di se ku ke rënë sonte për të bujtur?

— Te himarjotët...

— Nuk është e tëra. Po ta them unë. Ne jemi nëndë himarjotë. Ke dëgjuar për Himarën? Po. Jemi shtatë djem e dy vajza. Sapo ishim ndarë nga vajzat, kur të takuam ty. I çuam në shtëpinë e një fshatari, se atje flenë. Ne të nëndë bëjmë pjesë në brigadën «Ismail Mehmeti» të rinisë së Vlorës. Kemi marrë emrin e ushtarit që ra për të mbrojtur pasurinë e popullit. Kemi marrë emrin e shokut tênd!

Marku i hodhi tej bataniet dhe shtriu dorën. Ua shtërngoi të gjithëve me radhë.

Stefani vazhdoi:

— Jemi njëqind e njëzet e nëndë të rinj e të reja. Në mes tonë kemi edhe një plak. Kemi ardhur të zëvendësojmë të njëqind e njëzet e nëndë të plagosurit e rrëthit të Dibrës. Ai plaku që ka ardhur me ne, është babai i Ismailit. E quajnë Mahmut Mehmeti. Plak njeri, po zemrën e ka të re. Mbase më të re se të disave që janë të rinj vetëm nga mosha. E di si tha kur mori vesh për krijimin e brigadës që mban emrin e të birit? Po ta them unë:

«Po të qe gjallë im bir, me siguri do të vinte i pari në ndihmë të të dëmtuarve nga tërmeti. Me-

që nuk është ai, më lejoni të vi unë në vend të tij.»

Komiteti i rinisë e pranoi kërkesën e tij.

Marku u përlot.

— Unë e njoh xha Mahmutin. E kam takuar në spitalin e Durrësit, kur erdhi për të parë të birin. Ishim në një dhomë, unë dhe Ismaili. Ç'djalë!

Pastaj ngriti kokën dhe pyeti:

— Me ju është xha Mahmuti?

— Jo. Ka shkuar në një fshat tjetër këtu afër. Po do ta takojmë.

Marku nisi të tregojë për ngjarjet e asaj dite. Të asaj dite që sapo kish perënduar.

Kish arritur në Laç me tren. Frynte erë dhe ngrihej pluhur. Përpara ndërtesës së stacionit, një-rezit vraponin për të gjetur ndonjë kënd ku të mos i zinte era. U fut në sallë. Biletat për në Shkodër ishin shitur. Duhej të nisej me ndonjë kamion.

Hodhi trastën në kurriz dhe doli në rrugën automobilistike. Po vinte një maqinë. Nxori dorën përpara dhe thirri:

— Për Shkodër!

Maqina iku me shpejtësi. Nga pas u dëgjuau zëri i shoferit:

— Për Dibër!

Kaloi edhe një. Edhe një tjetër. Marku nxirrte dorën dhe thërriste:

— Për Shkodër!

Shoferët, duke u shkelur gazin maqinave, bërtisnin:

— Për Dibër!

Para syve të Markut, maqinat nxitonin për në Dibër. Nxitonin sikur t'i ndiqte njeri nga pas. Nxitonin ato që mbanin targën TR, nxitonin ato që mbanin targën VL, nxitonin ato që mbanin targën KO, KR, EL. Të gjitha maqinat nxitonin. Edhe ato që mbanin targën SH. Çonin tulla, tjegulla, hekur, çimento, dyer e dritare. Gjithçka duhet për ndërtimin e një shtëpie. Disa çonin edhe njerëz. Maqinat me njerëz, mbi kabinet kishin nga një beze të kuqe, ku shkruhëj: «Një për të gjithë dhe të gjithë për një!» «Një bie dhe njëmijë ngrihen!» Kishin edhe nga një flamur të kuq që rrihte palët në erë. Njerëzit këndonin. Edhe ata që udhëtonin në gaze, edhe ata që udhëtonin në autobuzë, edhe ata që udhëtonin në kamionë të hapur ku të priste era. Këndonin këngën e Avni Mulës:

Ecim...

Ecim edhe marshojmë!

Marku ish ulur mbi një gur dhe maqinat kalonin para tij me shpejtësi. Nuk ecnin, po fluturonin. Kalonin tulla, tjegulla, çimento, njerëz, parulla të kuqe, flamurë dhe copa këngësh.

Pak më tej ndaloi një maqinë. Shoferi zbriti me rrëmbim. Pështyu bishtin e cigares që kish në gojë dhe diçka tha. Marku nuk e dëgjoi, po e mori me mend se shoferi shau.

Shoferi po shikonte gomën. Marku u afrua dhe lexoi targën.

— Për në Shkodër je, o shok?

Shoferi e pa me inat.

— Hajt të ndërrojmë gomën njëherë. Masha-lla qenke si div. Më ndihmo.

Marku hoqi trastën nga kurrizi dhe e vuri në anë të rrugës. Bashkë me shoferin hoqën gomën, vunë tjetrën dhe pastaj fshinë duart me një leckë të lagur me benzinë. Të gjitha këto i bënë pa shkëmbyer asnje fjale.

— Për Dibër shkon?

— Po.

— Do të vij edhe unë me ty.

U nisën.

Kur kish parë se të gjitha maqinat dhe të gjithë njerëzit vraponin për në Dibër, edhe Marku kish ndërruar mendje. Zemra i thoshte të shkonte në Dibër për të ndihmuar të dëmtuarit nga tërmeti. Atje shkonte gjithë Shqipëria. Ku shkon Shqipëria, duhet të jetë edhe ushtari, edhe pse është i liruar. Madje duhet të jetë në ballë. Me uniformë ose pa uniformë, me shërbim të detyruar, apo rezervë, të gjithë jemi ushtarë.

Kështu, Marku u nis për në Dibër. Në drekë ja hipi maqinës në Laç dhe para mesit të natës arriti në Ostush. Tani ja ku ish në një çadër me himarjotët.

— Nga ç'fshat je, more shoku Mark?

— Nga Abati.

Stefani tha:

— Diçka kam dëgjuar e diçka di për Abatin. Atje ka shkuar vëllai i vogël vullnetar për dy vjet. Është murator.

— Ashtu?! Dashkam ta takoj. Do të bëhem miq me të, ashtu siç po bëhem me ju.

— Aksionet kanë shumë gjëra të mira, o Mark. Atje gjithmonë lindin miqësi të reja, lidhen shoqëri të ngushta, që nuk harrohen kurrë.

Genti tha:

— E dini ç'mendoj tan? Luftën dhe punën. Shkoi Zonja Çure për të çliruar veriun dhe ra. Shkoi Shkurte Pal Vata për të ndërtuar hekuru-dhën dhe ra. Shkoi Ismail Mehmeti për të mbrojtur vendin dhe ra. Ne, nga vendi i Zonjës, vimë për të ndihmuar dibranët. Vëllai i Stefanit shkon në Abat për të ndërtuar. Marku nga vendi i Shkurtës vjen në Dibër për të ndihmuar. Shkojmë anembanë Shqipërisë dhe njihemi më mirë, lidhemi më fort. . .

Ndaloi një çast dhe pastaj vazhdoi. Shokët e dëgjonin në heshtje:

— Ne në mes tonë kemi Zonjën. Marku sjell me vete Shkurtën. Zonja me Shkurtën takohen në Dibër. Takohen këtu, në Ostush. Takohen në çadrën tonë. Këtu takojnë Nazmi Rushitin. Njera heroinë e luftës. Tjetra heroinë e punës. Dhe tjetri hero i luftës. Këtu vjen e takohet edhe Ismail Mehiti. Edhe ky hero i punës. Një shkrimtar mund të bënte diçka të bukur me këtë subjekt, apo jo? Do t'ja them atij shkrimtarit që takuam atë natë. Nuk e kam parë më. Kushedi ku do të ketë shkuar.

— Ka shkuar në Maqellarë më duket. Po do të vijë prapë.

Marku dëgjonte. Stefani i hodhi dorën në sup.


— Ti, Mark, do t  rish me ne. Kemi nj  kre-
vat bosh n   ad r. H , si thua?

— Me gjithë qejf.

— Do tē tē pranojmë nē brigadēn tonë. Ti zë-vendëson Ismailin, se e ke patur shok. Keni qenë ushtarë bashkë.

— Po atë e ka zëvendësuar i ati.

— S'ka gjë. Edhe ti e zëvendëson. Edhe unë. Edhe këta. Të gjithë e zëvendësojmë. Kur bie një, ngrihen me mijra për ta zëvendësuar, apo jo?



VII

KUSHTET TEKNIKE DHE RINIA

ATË mëngjes erdhën dhe i zgjuan Pandora me Voisavën. Ato thirrën që larg:

— Çohuni, more gjumashë! Shokët kanë filluar nga puna.

Stefani flaku tej bataniet dhe tha:

— E morët hakun.

Genti shtoi:

— Pse, kështu merret haku? Ne ju zgjuam dhjetë ditë rresht, kurse ju vetëm sot.

U ngritën të gjithë. U ngrit edhe ushtari i liruar. Dolën para çadrave. Markun e njohën me vajzat.

Nëpër rrugët e fshatit venin e vinin njerëz. Disa me qeleshe, të tjerë me kasketa. Të tjerë me kokore. Kish edhe ndonjë me takie. Diku u duk edhe shkrimtari me beretë në kokë. Ekspozitë kapelesh. Vetëm borsalina mungonte.

Filluan të dëgjohen çekiçët e parë. Zjarret ishin ndezur gjithandej dhe në qìell ngriheshin shtëllunga tymi.

Rrugës, duke shkuar për në shtëpinë e Xhezair Brakës, përshëndetnin shokët:

— Mirëmëngjez, Tepeleña!

— Mirëmëngjez, Elbasani!

— Mirëmëngjez, Kruja e Skënderbeut!

Të tjerët ua kthenin përshëndetjen:

— Mirëmëngjez, Himara!

Genti shtonte:

— Edhe Dukagjini!

Markut i bëhej qejfi dhe ndjente kënaqësi kur dëgjonte fjalët Himara dhe Dukagjini.

Ndërsa Stefani mendonte:

«Pse të zemë me gojë gjithë ato qytete e krahina, kur kemi mundësi të themi: «Mirëmëngjes, Republikë!» Kështu është më mirë».

Më në fund ja edhe shtëpia e Xhezairit. Muret ishin ngritur dy metra mbi tokë. Do të ngriheshin edhe ca. Muratorët hipën në skela. Edhe marangozët. Muratorët ngrinin mur. Edhe marangozët ngri-
nin mur. Stefani marangoz ishte, po punonte si murator. Afër kish brigadierin e «21 dhjetorit». Ai e mësonte si të vinte tullat, si të shtronte llaçin me mistri, si të drejtonte murin me spango. Për disa ditë Stefani mësoi të bëjë mur. Mësuan edhe shumë të tjerë. Nuk ish edhe aq vështirë të ngrije mur. Pastaj zanati i marangozit me zanatin e muratorit janë vëllezër. Marangozi bëhet shpesh herë murator. Edhe muratori bëhet marangoz. Madje,

nëpër fshatra, marangozi është edhe murator e muratori është edhe marangoz.

Të tjerët po zienin ujët në fuçia të mëdha. Edhe në kazanë. Kazanët i kishin marrë te fshatarët. Me këtë ujë bëhej llaçi. Ujë i valuar, kripë, rërë dhe gëlqere. Një përzierje e fortë, që nuk i bënte asgjë ngrica.

Xhezairi ish vetë murator. Në fillim nuk pranoi ta ndërtonte shtëpinë. Jo se në shesh kish qenë tyrbja. S'pyeste Xhezairi nga aio anë. Ai e kish hallin gjetiu dhe thosh:

— Nuk zë llaçi në ngricë. Do të rrëzohen murat.

Brigadieri i «21 dhjetorit» i përgjigjej:

— Edhe unë ashtu si ti mendoja më parë. Kam dyzet vjet murator. Asnjëherë s'kam ndërtuar shtëpi në ngricë. Kujtoja se nuk zinte llaçi. Kështu thoshin kushtet teknike të ndërtimit. Mirëpo këtë vit kushtet teknike të ndërtimit i kthyen kokëposhtë në Dukagjin. Dhe e di kush i ktheu? Rinia! Ju lumtë! Ku pyet rinia për kushte teknike. Kushtet teknike janë bërë rrëth sobës, në ndonjë zyrë. Muret bëhen jashtë, në borë e në ngricë. Prandaj edhe rinia u vuri qysqinë.

Xhezairi donte t'i priste fjalën, po brigadieri i «21 dhjetorit» nuk e linte:

— Në Dukagjin mendonin si ti, Xhezair, dhe si unë. «S'ndërtohet muri në ngricë», thoshin. Muratoriët e rinj e ngrohën ujin i hodhën kripë llaçit dhe e ndërtuan shtëpinë e Pal Vatës. Dhe ç'mure kanë bërë se! Jo sikur i kanë ngritur me gurë e

me llaç, po sikur kanë derdhur betonarme.

Xhezairi përpinqej ta ndërpriste, po brigadier i «21 dhjetorit» nuk e lejonte përsëri:

— Këto i lexova në gazetë, shoku Xhezair. Pashë edhe fotografinë e shtëpisë që ndërtuan të rinjtë. Edhe ti besoj e ke parë.

Tjetri pohoi me kokë.

— Dyshova ca në fillim. E them hapur se dyshova. Pas ca ditëve më vjen im nip nga Dukagjini. Kish marrë pjesë në ndërtimin e shtëpisë së Pal Vatës. Është murator. E kam nxjerrë nga këto duar. Ky nipi, sikur ta dinte dyshimin tim, kish marrë një grusht llaç me vete. E kish futur në një copë rrobë. Ma dha në dorë dhe më tha:

— Shkatërroje, po qe i zoti...

— Provova ta thërmoj, po nuk ja dola dot. Këto duar që thërmojnë tullën, nuk e thërmuan dot llaçin e preqatitur në Dukagjin. Ish çimento e shkuar çimentos. E hodha në zjarr që të provoj fortësinë në nxehësi. As zjarri s'i bëri gjë. Atij llaçi s'i bënte gjë as ngrica, as zjarri. Ja kështu, o shoku Xhezair. I përbysyi kushtet teknike rinia. Na mësoi edhe neve, që u plakëm në këtë zanat.

Xhezairi priti sa mbaroi brigadier i «21 dhjetorit», pastaj tha:

— Kur është ndërtuar shtëpia e Pal Vatës në Dukagjin, në mes të ngricës, hajt ta ndërtojmë edhe timen. Në Dukagjin bën më ftohtë se në Ostush. E di mirë këtë, se atje kam bërë ushtrinë.

Kështu ish tërhequr Xhezairi. Dhe vetë kish vënë tullën e parë në murin e shtëpisë së re. Duke

ndërtuar e duke parë me sy se llaçi u lidhka më mirë me ujë të valuar. Sa të rrash do të mësosh, ka thënë i pari.

Një kolonë grash u duk në të hyrë të fshatit. Vinin duke kënduar. E para mbante një flamur.

— Erdhën gratë e Peshkopisë! — tha dikush.

Ato ishin gra që shpérndaheshin nëpër fshatra, për të ndihmuar të dëmtuarit nga tërmeti. Çdo mëngjez vraponin për në çerdhe e kopshte më fëmijë në duar, pastaj vraponin për të hipur në makina. Hipnin. Zbrisnin nga një grup në çdo fshat dhe punonin që në mëngjez, gjer në mbrëmje. Pastaj ktheheshin prapë me maqina. Ato zbrisnin në qytet dhe nxitonin nëpër çerdhe e kopshte. Merrnin fëmijët dhe futeshin nëpër shtëpitë e ngrohta. Të nesërmen në mëngjes nxitonin përsëri. Dhe shkonin në fshatra me këngë në gojë.

Kur vinin ato, të gjithë linin punën. Nëpër skela njerëzit tundnin çekiçët e mistritë për t'i përshëndetur. Ata që përzienin llaçin, tundnin loapat. Ata që mbarnin tullat, tundnin pishtarët. Se pa pishtar nuk shkuleshin tullat nga vendi. Ato ngjiteshin me njera tjetrën nga akulli dhe nuk bënte punë as çekiçi, as kazma. Thyheshin tullat dhe akulli s'pësonte gjë. Vetëm pishtari i shkulte nga vendi. Vendosnin njerëzit **copa** gomash në majë të shkopinjve dhe u vinin zjarrin. Gomën e ndezur e kalonin nëpër rreshtat e tullave dhe akulli shkrinte. Kaq duhej. Pastaj hynin në punë duart. Duar me doreza e pa doreza. I kapnin tullat dhe i ndanin nga njera tjetra. Duke i ndarë, Stefani kish

lënë copa lëkure në to. Edhe Pandora. Edhe shumë të tjerë. Në fillim kishin lënë dorezat. Pastaj copa lëkure nga mollëzat e gishtirinjve.

Kur vinin gratë e Peshkopisë, fshatarët nëpër ara tundnin belat, nxënësit te oborri i shkollës së re tundnin çantat me libra e fletore, ndërsa plakat linin fëmijët në djepe dhe vraponin nëpër dritare apo dilnin në rrugë për t'i përshëndetur. Ato çaste ishin vërtet prekse. Gratë e Peshkopisë ecnin nëpër borë dhe këndonin, ndëra në ajër tundeshin çekiçë, mistri, lopata, bela, pishtarë, çanta dhe duar plakash, që dinin të tundnin vetëm fëmijët.

Gentit, që çdo gjë e vështronë me syrin e artistit, kur shikonte këtë tablo të bukur, i kujtohesin piktorët. Kishin ardhur edhe piktorë në Dibër. Genti kish takuar dy. Ata mund të bënin një tablo të bukur për gratë e Peshkopisë. Pse, vetëm një? Mund të bënin edhe më shumë.

Dikush thirri me të madhe:

— Mbaroi muri!

Një tjetër shtoi:

— Tani, o burra të hedhim çatinë.

Po me se? Qeresteja po vonohej. Ish nisur një karyan me kafshë që me natë dhe ende nuk po kthehej. Duhej të prisin. Kohë e humbur kot. Po çmund të bënin?

Te brigadieri i «21 dhjetorit» u afroa një plak. I kish të gjashtëdhjetat, në mos më shumë. Diçka desh t'i thoshte, po u kthyte dhe zbriti poshtë, në sheshin para shtëpive. Po hante thonjtë me dhë-

mbë. U ngjit prapë në skelë. U ngjit e zbriti disa herë. Më në fund ju afrua brigadierit të «21 dhjetorit» dhe nisi t'i thotë diçka. Brigadieri nuk po e kuptonte. Plaku i ngatërronte fjalët. Pastaj e kuptoi q'donte të thoshte. E kuptoi edhe pse i ngatërronte fjalët.

Plaku ish komshi i Xhezairit. Qysh prej dytre vjetësh kish nisur të mblidhët qerestenë për të ndërtuar një shtëpi të re. I kish të gjitha gati: tullat, tjegullat dhe lëndën e drurit. Po të mos kish rënë tërmeti, do të fillonte të ndërtonte shtëpinë. Mirëpo ra tërmeti. Atij nuk ju prish shtëpia. As ju dëmtua. Xhezairit ju bë rrafsh me tokën. Plaku mund të rrinte edhe ca kohë në shtëpinë e vjetër. Kurse Xhezairi kish nevojë të futej sa më parë nën çati. Fëmijët i kish të shpërndarë lart e poshtë. Duhej t'i mblidhët rrëth vatrés.

«Po sikur t'ja falte qerestenë Xhezairit?»

Në mendjen dhe në shpirtin e plakut luftonin dy vetë. I pari thosh:

— Falja qerestenë Xhezairit. E ke vëlla!

I dyti e kundërshtonte:

— I jep shteti atij. Mbaje për vete, se të duhet. Me çfarë do ta mbulosh shtëpinë e re?

Kur dëgjonte këtë zë, plaku largohej nga brigadieri i «21 dhjetorit». Kur dëgjonte zërin e parë, i afrohej. Më në fund vendosi:

— Merrni qerestenë e shtëpisë sime.

Nuk kish nevojë për më shumë fjalë. Të gjithë e kuptuan plakun. Edhe brigadieri i «21 dhjetorit». Po më mirë se të gjithë e kuptoi Xhezairi

që shkoi e përqafoi dhe e puthte i mallëngjyer.

Shkuan dhe e morën qerestenë. Vetë plaku e mori trarin e parë. E mbante në krahë. Në një cep plaku, në një cep Stefani.

Ecnin me tra në krahë. Bora gjer në gju. Plaku çante përparrë. Nuk pranoi të rrinte pas. Stefani ecte pas tij dhe thosh me vete:


«Edhe ky është një hero i ditëve tona. Ai e shkelmoi interesin vetjak!»

Duke menduar këto, dëgjoi brigadierin e «21 dhjetorit» që thërriste:

— Erdhi qeresteja! Erdhi qeresteja!

Tutje, në mes të borës, po nxinte kolona me kafshë.

Stefani shikon plakun. Ai ecte me tra në krahë dhe nuk e ktheu hic prapa kokën. E kish dhënë fjalën. Kish dhënë edhe qerestenë. E kish dhënë me gjithë zemër. S'kish pse ta kthente kokën prapa.



VIII

NË UJRAT E DRINIT

Në dhomën e brigadierit të «21 dhjetorit» ishin mbledhur gjithë ata njerëz. Aty ishte shkrimitari me beretë në kokë, gazetari, Stefani, ai korkçari që këndonte me kitarë, Myftari, Marku dhe plot të tjerë. Në mes të dhomës ngrohte soba. Mbi sobë po thekeshin copa buke. Të gjithë, në njëren dorë mbanin pjatën me groshë, ndërsa në tjetrën lugën.

Groshën e gatuajnë mirë në Dibër. Sidomos kur e bëjnë me mish. Të tillë groshë u kish pre-gatitur edhe Myftari atë ditë. Hanin me shije të madhe. Hanin dhe bisedonin. E kishin fjalën te një artikull që kish botuar gazetari atë ditë. Ish një reportazh.

Sapo i kishin marrë gazetat. E lexuan me zë reportazhin. Genti e lexonte dhe ata dëgjonin. Kur mbaroi leximi, Stefani i tha gazetarit:

— Shumë mirë e ke shkruar. Sidomos atë pjesën ku flet për Halim Pikun që mposhti dhëmbjen e humbjes së nipit. E ke qarë. Na e lexo edhe njëherë atë pjesë, o Gent.

Tjetri e lexoi.

— Po një gjë nuk më pëlqen, — vazhdoi bisedën që e kish lënë përgjysmë Stefani. — Reportazhin e ke mbyllur me një shembull të keq. Slikur nuk vete. Flet e flet për sakrificat, për heroizmin, për gjithçka të mirë e të bukur që po shohim e po jetojmë këtu, dhe pastaj nxjerr një teknik që e ndan qerestenë me hatër.

Gazetari ju përgjegj:

— Ja që ka edhe njerëz të tillë...

— Ka, si nuk ka. Po këta janë të rrallë. Mbasse edhe i vetmi. Në njëmijë shembuj të mirë do të jetë edhe një i keq.

— Meqë është, ta goditim, që të mësojnë të tjerët. Pse kemi ardhur këtu? Të ndihmojmë të dëmtuarit nga tërmeti dhe të mësojmë. Mësohet edhe nga e mira, edhe nga e keqja.

Brigadieri i «21 dhjetorit» ja preu fjalën në mes:

— E dërmoi kolektivi atë. S'kemi ç'mësojmë nga ai teknik. Unë jam me Stefanin. Më mirë të kiske shkruar për ndonjë teknik që e ndan me drejtësi qerestenë.

Gazetari nuk pranonte. U hëngrën gjatë përkëtë. Shkrimtari me beretë në kokë i hodhi uje verës:

— E kemi vështirë t'i pranojmë kritikat, mo-

re shokë. Ja, kur më thonë mua se aksh fjalë nuk e kam mirë, sikur më bie tavani në kokë. Pikërisht atë fjalë më duket se e kam më mirë nga të gjitha. Më dhimset ta heq.

Brigadieri i «21 dhjetorit» i tha:

— Hajt se do mësoni, mos u bëj merak.

Pjatat u mblodhën stivë. Stefani tha:

— Sikur të kishim edhe nga një çikë verë tanë, nuk do të qe keq.

— Dukesh që je himarjot. Te vera e ke mendjen.

— Ka në dyqan. Shkojmë të blejmë?

Genti nuk priti përgjigje, po u nis. Sa doli jashtë, takoi fëmijët e Myftarit. Po vinin për të marrë pjatat. Ishin dy vajza dhe një djali. Vajza e vogël i ngjante shumë Lumes.

— Erdhëm ne, — tha djali.

— Ja ku i keni pjatat.

Pandora u tregoi vendin.

— Xhaxhi Stefan, — tha vajza e vogël që i ngjante shumë Lumes, — ku do të punoni sot?

— Te shtëpia e Halimit, moj Liri.

— Do të vimë edhe ne. Do të mbartim tulla.

— Ejani, se ju presim. Po nuk erdhët ju, nuk e fillojmë punën.

Fëmijët morën pjatat dhe ikën. Genti u kthyesh me tri shishe verë «Mavrud». Xhepat i kish të fryrë, sikur t'i kish mbushur me topa të vegjël. Ishin portokalle.

— Janë nga të Himarës. Dyqani është mbu-

shur plot me portokalle e me limona. Ka edhe mandarina.

Të gjithë morën nga një kokërr. Hiqnin në shishe me radhë dhe hanin nga një thelë portokall.

Shkrimtari me beretë në kokë tha:

— Shkon shumë portokallja me verë dhe...

Pandora ja mori fjalën nga goja:

— Dhe mjalti me arra.

Genti po lexonte faqen e katërt të gazetës. I hodhi sytë në disa tituj dhe pastaj lexoi me zë të lartë: «Njoftim mbi masat që po merren në Di-brën e Madhe për të démtuarit nga tërmeti».

Të gjithë e ndërprenë bisedën.

— Vazhdo, — thanë disa.

Genti lexoi:

«Sipas agjensisë jugosllave «Tanjug»... Vecja Ekzekutive... dërgoi në ndihmë të të démtuarve nga tërmeti 2000 copë tulla...»

Brigadier i «21 dhjetorit» tha:

— Me këto tulla ndërtohet një kotec pulash. Asgjë tjetër.

Gazetari shtoi:

— Çdo shtëpie të démtuar i bie nga një gjysmë tulle, më duket. Ndihmë e madhe shumë... E ç'mund të bësh me një gjysmë tulle?

— Mund të zësh ndonjë brimë, që të mos futen pulat në dhomë...

Qeshën të gjithë. Genti vazhdoi leximin:

«Ka dërguar edhe 150 kv. gëlqere...

— Kjo qenka ç'qenka! Për çdo shtëpi paskan dërguar nga 15 gram gëlqere.

— Pse ua kanë dërguar, që ta pinë si sodë kur t'u dhëmbë stomaku?

Prapë qeshën të gjithë.

«Ka dërguar edhe 3000 kg. hekur...»

Stefani pyeti:

— Sa the? 3000 kv, apo 3000 kg.?

— 3000 qillo!

— Sipas hesapit tim, çdo shtëpie i takon të marrë nga 10 gram hekur...

— Kaq hekur mund ta marrësh brenda një dite, po të hash drekë e darkë spinaq. Ka shumë hekur spinaqi...

Qeshën përsëri. Këtë radhë më fort.

Brigadieri i «21 dhjetorit» tha:

— Ne qeshim me ndihmën qesharake, po vëllezërit tanë janë keq matanë kufirit.

— Disa po i shpërngulin.

— Shpërngulin vetëm shqiptarët. Serbët nuk i luan kush.

— Titua u kërkoj lëmoshë të gjithëve: Papës, Xhonsonit, Kosiginit...

— Dhe të gjitha ato që mblođhi duke lypur, i hëngri për vete.

— Në Kojaxhik, dy fëmijët që kishin mbetur pa strehë, i hëngri ujku.

— Në Bomovë u gjetën një burrë e një grua të ngrirë. Flinin jashtë, në borë.

Myftari tha:

— Ja ku i kemi, karshi. Gjer tani, në Kojaxhik nuk është ndërtuar asnje shtëpi. Te ne po mbarojnë të tëra. Të mbarojnë për një muaj, tha par-

tia. Për njëzet ditë do t'i mbarojmë ne në Ostush.

— Edhe më përpara.

Dikush nga jashtë thirri:

— Ej! Çohuni ju që jeni aty brenda! Mjaft përrallisët rrëth sobës.

U ngriten dhe dolën jashtë. Në rrugët e fshatit kalonin njerëz me kokore, qeleshe, takie, kas-keta. Aty afér dukej bereta e shkrimtarit. Mungonte vetëm borsalina. Kalonin rrugëve dhe këndonin. Festival këngësh e ekspozitë kapelesh. Këndonin këngë labe, korçare, shkodrane.

— Ja fillojmë edhe ne? — tha Stefani.

Dhe ja morëm himarjoçe. Njeri ja merrte, tjetri ja kthente dhe Pandora ja hidhte. Të tjerët bënin iso.

Shkrimtari me beretë në kokë mendonte:

«Ç'zë që ka kjo Pandora. E ngre aq lart dhe e dredh aq bukur, sa nuk mund ta kapë asnjë notë muzikore.»

Te sheshi u ndanë. Disa shkuan lart. Të tjerët u nisën poshtë. Stefani me Markun dhe me gjashtë himarjotët e tjerë u nisën për në Drin. Nga anë të tjera të fshatit po zbrisnin për në Drin fshatarë, ushtarë, punëtorë e fëmijë. Po fëmijët ç'donin në Drin? Të rriturit do të futeshin gjer në brez në ujët e Drinit të Zi, ndofta edhe gjer në grykë, dhe do të nxirrnin rërë. Në fillim do të çannin akullin me lopata dhe do të futeshin në ujë. Ujët do t'u hynte në çizme dhe do t'u lagte rrobat. Të ftohit do t'u hynte në palcë, po ata do të

vazhdonin tē rrinin nē ujë dhe tē nxirrin rërë. Tē tjerët do tē mbushnnin arkat e koshat me rërë dhe do tē ngarkonin kafshët. Po fëmijët? Ata do tē vinin pérpara kafshët e ngarkuara dhe do t'i çonin nëpër shtëpitë që ndërtoheshin.

Drini i Zi kish veshur një cipë akulli. Nën cipën e akullt rridhnin ujrat. Në breg tē lumi zbritën dhjetra vetë. Zbriti edhe Stefani. Lopatat u ulën nga supet dhe nisën tē godasin nē akull. U krijua një e çarë. U krijuan dy, tri. Afër bregut filuan tē notojnë copat e akullit tē thyer.

Stefani përveshi mëngët e trikos. Përveshi gjer lart edhe këmbët e pantallonave dhe u fut nē ujë. Ndjeu një tē dridhur, sikur ta zinte korenti. Futi lopatën dhe pastaj e nxori. Në breg u zbras lopata e parë me rërë.

IX

SHTËPIA E FUNDIT

AJO ish shtëpia e fundit që do të ndërtonin.

Ju kujtohet plaku që bridhte anembanë fshatit me fener në dorë? Shtëpia e tij po ndërtohej.

E bija ishte shëruar dhe kish shkuar në hekurudhë. Plaku kish marrë letrën e parë prej saj. Letër kish marrë edhe Myftari. Edhe të tjerët. U shkruanin vajzat nga hekurudha. Donin të mësonin se ç'bëhej në fshat. Dhe familjet nga Dibra u kthenin përgjigje.

Ishte mbrëmje. Nëpër shtyllat e skelave ishin varur llambat me vajguri. Edhe mbi çati kish llamba të tilla. Edhe në shesh.

Në çati po mbërthehesin listelat e fundit. Gjëmonte çekiçi. Dëgjoheshin thirrje. Brenda po shtrohej dyshemeja. Lart po mbërthehej tavani. Dyert e dritaret ishin vënë. Edhe xhamat. Në oxhak

qe ndezur zjarri. Ata që punonin, vinin në vatër, ngrohnin duart shpejt e shpejt dhe i knin. Plaku me fener në dorë i hidhte dru zjarrit.

Në shesh venin e vinin njerëzit me pishtarë në dorë. I afronin te stivat me tjegulla dhe i kalonin nëpër to. Pastaj i kapnin tjegullat me të dy duart dhe ua kalonin të tjerëve. Nga një dorë në tjetrën, tjegullat gjendeshin sakaq në çati.

Brigadieri i «21 dhjetorit» mbështeti këmbët te një tra i kulmit të shtëpisë, drejtoi trupin dhe tha:

— Na duhen edhe nja dhjetë listela!

Stefani që po mbërrhente një gozhë, i thirri Gentit:

— Ka më listela aty?

— Jo. Mbaruan.

— O burra të gjejmë nja dhjetë copë!

— Me siguri do të ketë te shtëpia e vjetër e plakut. Po shkoj të shoh te ata që pastrojnë gërmadhat.

Genti shkoi te shtëpia e vjetër e plakut. Aty nuk po punonte njeri. Ishin mbledhur të gjithë rrëth Pandorës dhe, nën dritën e katër llambave, po shikonin një çantë nga ato që mbajnë oficerët. E kishin gjetur në mes të gërmadhave, kur po nxirrin dhogat dhe trarët. Në xhepat e jashtëm të çantës ishin dy kalema. Një i zi dhe një kuq e blu. Nga lagështia ishin rronitur fare. Sa i zunë me dorë u shkoqën dhe u bënë copë-copë.

Genti thirri:

— Ja jepni plakut çantën dhe shpejt të çoj-

më dhjetë listela, se na mbeti çatia pa hedhur. Sonte do ta mbarojmë shtëpinë e plakut gjallë a vdekur. Nesër nisemi të gjithë.

— E mbarojmë dot?

— Edhe pyet? Për pak vijnë ushtarët dhe gjithë specialistët e vullnetarët e tjerë në shtëpinë e plakut. Mbaruan punimet kudo. Dyshemeja u hodh. Edhe pjesa më e madhe e tavanit. Tani ka mbetur vetëm për t'u mbuluar. Tjegullat i kemi ngjitur në çati.

Zgjodhën dhjetë-pesëmbëdhjetë listela dhe ja çuan brigadierit të «21 dhjetorit». Stefani me brigadierin i mbërthyen. Njeri këndeje e tjetri andej. Kur mbaruan punë, thirrën të dy tok:

— Tani të vendosim tjegullat.

Nga anët e tjera të çatisë kish filluar mbulimi i shtëpisë. Tjegullat po i afroheshin kulmit.

Sheshi u mbush plot. Në fshat i kishin mbaruar të gjitha shtëpitë. Njerëzit ishin futur brenda. Në vatër ishin ndezur zjarret dhe po piqeshin gështenjat. Fëmijët hanin dhe dëgjonin. Plakat trengonin përralla. Jo përralla me mbret e me magjistarë. Përralla me njerëz të vërtetë. Përralla me vullnetarë e me specialistë. Përralla ku shtëpitë ndërtoheshin sa të hapësh e të mbyllësh sytë.

Në shesh erdhën ushtarët, vullnetarët e specialistët e gjithë Ostushit. Erdhën edhe fshatarët. Burra e gra. Edhe fëmijë. Të tërë tok do të ndërttonin shtëpinë e fundit. Shtëpinë e plakut me fener në dorë. Ushtarët po vendosnin poçat e elektrikut nëpër skelë. Edhe brenda nëpër dhoma. Në

shesh gjëmoi motori dhe nata u bë si ditë.

— Shuan i llambat me vajguri. Nuk na duhen më.

— O po flakini në Drin!

Myftari thirri me të madhe:

— Na duhen edhe ca kohë. Mot do t'i hedhim me të vërtetë në Drin.

— Jo në Drin. T'i mbani si kujtim. Çdo shtëpi të krijojë nga një kënd, si muze, ku të vendosë bishtukun dhe llambën.

Nga brenda dolën marangozët. Doli edhe plaku. Dyshemeja edhe tavani kishin mbaruar.

— E gëzofsh shtëpinë, o xhaxho, — tha dikush.

— Prit, ore, se s'ka mbaruar çatia akoma! Nuk të durohet edhe pak?

Plaku nuk fliste fare. E kishin mbytur lotët. Shikonte shtëpinë dhe qante. Qante nga gëzimi. Dhe mendonte:

«U ngrit shtëpia si në përralla. Sikur të ishte gjallë ime shoqe me tim bir dhe ta shikonin... Do të fluturonin nga gëzimi... Po s'ka gjë. Do ta shikojë Lutfia kur të kthehet nga hekurudha. Njëlloj éshtë.»

Qante plaku nga mallëngjimi. Në gëzim qanjeriu. Kur ka gëzim, i sillen rrëth edhe të afërmit që s'janë më. Prandaj qan jeriu kur ka gëzim të madh.

Në shesh filloi kënga. Ai korçari me kitarë i kish lënë mënjanë Marjankat. Këndonte këngë revolucionare.

«More, po si nuk i ngrijnë duart duke i rënë kitarës në këtë të ftohtë!», habitej Stefani.

Një tjetër po i binte çiftelisë. Edhe Marku dinte t'i binte, po nuk e kish me vete.

— Bini, more! Ju këndoftë zemra!

— Kur këndon, punohet më shpejt.

Tjegullat e fundit fluturuan sa në një dorë në tjetrën. Lart, mbi çati, kishin hipur shumë njerëz. Aty kish hipur edhe shkrimtari me beretë në kokë. Edhe gazetari. Shkrimtari ja jepte tjegullat brigadierit të «21 dhjetorit». Gazetari ja jepte Stefanit. Këta i vendosnin njerën mbi tjetrën, së-rë-së-rë.

Donin të hipnin edhe të tjerë në çati, po brigadieri i «21 dhjetorit» i ndaloi:

— Asnjë njeri lart! Mos doni të thyeni tjegullat? Apo doni të rrëzoni çatinë?

Stefani shtoi:

— Apo ka qejf të bjerë nga çatia ndonjeri? Rrini poshtë dhe këndoni. Hidhni edhe valle që të ngroheni.

Duke i dhënë tjegullat brigadierit, shkrimtari i thosh gazetarit:

— Kjo është shtëpia më interesante që kam parë gjer më sot. Atë po e ngrenë ushtarët, punëtorët dhe fshatarët.

Gazetari vuri buzën në gaz:

— Edhe intelektualët!

— Edhe gazetarët!.. Pastaj, këtë shtëpi po e ndërtojnë tiranas, himarjotë, elbasanas, korçarë, dukagjinash...

— Edhe devollinj. I harrove fare.

Në këtë shtëpi gjen tullat e Fierit, çimenton e Vlorës e të Shkodrës, tjegullat e Korçës, hekurin e Elbasanit, dyert e dritaret e Tiranës.

— E di si them unë? Këtu duhet të vemë një pllakë përkujtimore, ku të shkruhet: «Këtë shtëpi e ndërtoi gjithë Shqipëria!»

— Bukur të shkoi në mend.

— T'u themi muratorëve që të venë një pllakë çimentoje.

Dhe ja thanë brigadierit të «21 dhjetorit». Brigadierit i pëlqeu ky mendim.

— Do ta bëjmë edhe pllakën. Shiritin le ta presë i zoti i shtëpisë vetë. Sa të mbarojmë, do ta inaugurojmë.

Radhët e tjegullave shtoheshin me shpejtësi. Edhe dhjetë radhë. Edhe tetë... Edhe pesë... Edhe një radhë dhe çatia u mbulua.

Brigadieri i «21 dhjetorit» vuri tjegullën e fundit, mbërtheu flamurin e kuq mbi çati dhe thirri:

— E gëzofsh, o i zoti i shtëpisë!

Të gjithë, ata që ishin poshtë, ata që ishin në çati dhe ata që ishin brenda, thirrën:

— E gëzofsh!

— E gëzofsh! — përsëritën fushat, grykat e malet.

Këtë urim e dëgjoi gjithë fshati. Ndofta e dëgjuan edhe matanë kufirit. Me siguri e dëgjuan të gjithë ata që flinin jashtë, nëpër gropat e kasolle. Atyre nuk kish për t'u thënë askush:

— E gëzofshi!

Të gjithë po i shterngonin dorën plakut.

Zbritën nga çatia. Erdhën edhe ata që po nxirrin lëndën e drurit nga gërmadhat. Pandora kish hedhur në krah çantën. Plaku u ngjit te shkallët e skelës dhe tha:

— Sonte ju kam miq. Bujrum!

— Nuk na nxë të gjithëve.


— Na nxë, na nxë. Do të rrimë më këmbë.

— Të zgjedhim përfaqësues.

U futën brenda ushtarë, specialistë, vullnetarë dhe fshatarë. U futën edhe fëmijë. U ulën rrëth e rrëth oxhakut dhe gotat e rakisë kaluan dorë më dorë.

Në kënd të vatrës u ngrit plaku dhe tha:

— Këtë shtëpi e ndërtuan bijtë e partisë nga gjithë Shqipëria. Ta pimë pér partinë dhe pér bijtë e saj!



X

ÇANTA E PARTIZANIT PA EMËR

PANDORA shkoi afër plakut. I dha çantën.

— E gjetëm në gërmadha...

Plaku hapi sytë.

— S'kam patur çant të tillë... Mos e ke gabim?

— Në shtëpinë tënde e gjetëm, — thanë disa.

Brigadier i «21 dhjetorit» e mori çantën nga duart e plakut dhe, duke e hapur, tha:

— Po të ketë gjë brenda, gjendet i zoti menjëherë.

Nga çanta nxori një hartë të grisur në shumë vende, një blok të trashë dhe një copë letër të mbështjellë me shumë kujdes e të palosur disa herë. Faqet e para të blokut nuk lexoheshin fare. Nga lagështia, boja ish hapur e zbehur. E panë faqe për faqe, po emrin e të zotit nuk e gjetën as-

kund. Në blok lexoje data, emra vendesh e njërzish, përpjekje me italianë e gjermanë, rrugë të gjata nëpër borë, mikpritje malësorësh. Ish një ditar partizan. Kush vallë e kish shkruar?

Kontrolluan edhe hartën. As aty nuk ish emri i të zotit.

Brigadieri i «21 dhjetorit» nisi të shpalosë letrën e mbështjellë me kujdes. E hapi disa herë. Prej saj ra një fotografi. Ish një fotografi e mbajtur mirë. Në të kish dalë një partizan. Në kokë kapele me yll të kuq. Në krahë një automatik gjerman. Në rryp varur disa karikatorë me fishekë, një revolver dhe dy bomba.

Brigadieri lexoi shënimin prapa fotografisë: «Fitores, nga babai partizan».

Asgjë tjetër. As emër, as vend, as datë.

Kur dëgjoi këto fjalë, Stefanit diçka i ndjeu zemra. Plaku e mori fotografin, e pa me kujdes për shumë çaste dhe tha:

— M'u kujtuan të gjitha. Do t'ua tregoj tani ato që mbaj mend.

Dhe nisi të tregojë. Qe një tregim i thjeshtë, për një partizan të thjeshtë. Plaku e mbante mend mirë atë partizan. I kujtonte trupin, fytyrën, buzëqeshjen. Ja, sikur e kishte përparrë si në janarin e vitit 1944. Pak ditë e kish parë atë fytyrë, po nuk e kish harruar.

Partizanin e sollën dy vetë në shtëpinë e plakut. E solli i biri me një partizan tjetër. Se djali i madh i plakut kish qenë partizan. Partizani që so-

llën ish plagosur rëndë në një përpjekje me gjermanët e ballistët, diku midis Bulqizës e Shupenzës. Ish plagosur në kokë. E kishin lidhur me fasha. Fashat qenë gjakosur.

Partizanët i ndiqnin. Të plagosurin e kërkonin. E hipën në tavan. E vendosën afër oxhakut që të ishte ngrrohtë. Aty i rregulluan një dyshek dhe e mbuluan. E mbuluan me gjithë ato rrøba, se partizani qe si në ethe. Dridhej dhe fliste përcart. Aty afër i lanë edhe automatikun e çantën.

— Amanet, baba, — tha i biri. — Mos ë dorëzo pa vdekur edhe vetë.

Partizani tjetër shtoi:

— Përdor automatikun po qe nevoja. Do të kthehem shpejt.

— Hajt, djem, se e di vetë atë punë, — i qetësoi plaku.

Ata të dy u nisën.

Plaku më shumë rrinte në tavan, se në dhomën e zjarrit. Roje bënte e shoqja me fëmijët. Të plagosurit i jepte ilaçet që i lanë të dy partizanët. I vinte copa akulli në ballë. Edhe atëhere ish dimër i egër, si ky i sivjetmi. Edhe atëhere bora kish ngrirë e ish bërë akull. Çdo dy ditë i ndërronte plagën. Partizani digjej si furre. Ish zbehur e tretur. Fliste përcart. Plakut nuk i kujtohej c' thoshte. Kish kaluar shumë kohë qysh atëhere. Kur i binte temperatura, në fytyrë i endesh buzëqeshja. Ndofta kujtonte të afërmit dhe qeshte. Ndofta kujtonte shokët. Ku ta dish. Donte ujë. Kërkonte vazhdimi. Asgjë tjetër s'donte. As bukë, as duhan. As

rënkoj, as u ankua kurrë. Plaku nuk dëgjoi asnjë «ah!» prej tij.

Kështu jetoj gjashëtë ditë partizani. Të shtatën ditë erdhi i biri i plakut me atë partizanin tjetër. E morën dhe e çuan në një spital partizan që ndodhej në pyje, diku larg, andej nga Martaneshi.

Si e kish emërin partizani? Plaku nuk e dinte. Nga ishte partizani? As këtë s'e dinte plaku. Por e mbante mend mirë. Ja, sikur e kish përparrë syve, si në janarini e viti 1944.

Emrin nuk ja mësoi dot. Nuk mësoi dot as përfatim e tij. I biri që mund t'i tregonte, nuk u kthyen më as vetë. U vra në Shpat të Elbasanit.

Dhe ja tani çanta e partizanit pa emër. Kur e morën partizanin, ditën e shtatë, çantën e harruan. Ish natë dhe mbase nuk e panë. Automatikun e morën. Çantën jo. Ndofta e harruan. Jo ndofta, po e harruan. Mbeti çanta për sa e sa vjet në tavanin e çatisë. Dhe ja ku e gjetën rastësisht. Si nuk u ngjit të paktën njëherë në tavan plaku gjatë gjithë këtyre vjetëve? I vinte keq për këtë.

Kaq tha plaku dhe heshti.

Fotografia e partizanit pa emër kalonte dorë më dorë. E shikonin vullnetarët, specialistët, ushtarët, fshatarët dhe fëmijët. E shikonin dhe ja kationin shoku shokut.

E mori edhe Stefani. Ju drodhën duart. Ju drodh edhe trupi. Zemra i rrahu fort.

— Për këtë partizan do t'ju tregoi edhe unë pak, — tha.

Pyetën shumë vetë:

— Pse, e njeh?

— Po.

Dhe Stefani vazhdoi bisedën që plaku e la përgjysmë.

Partizanin pa emër e quanin Llambro. Ish nga Bregdeti. Kish një vajzë të vogël, as një vjeçë. Ja kish vënë emrin Fitore. Vajza e gjëzoi emrin dhe fitoren, po të jatin nuk e pa kurrë. U rrit dhe ftyrën e babait nuk e mbante mend fare. Ku mund ta mbante mend një foshnje një vjeçë? Llambrua s'kish lënë asnjë fotografi. Çoban fshati qe ai. As që i shkonte në mend të dilte në fotografi. Ç'i duheshin fotografitë çobanit?

Llambrua u shërua në spitalin e Martaneshit dhe u kthye në brigadën e tij. Pastaj i ra anembanë vendit. Shkoi edhe në Kosovë. Aty u vra. As trupin ja gjetën, as fotografi nuk kish që ta shikonte e bija. U rrit vajza pa e njojur të jatin. Tani është grua. Ka mbaruar përmjeke. Sa do të gjëzohet kur të marrë fotografinë e të jatit. Do ta shikojë pas vdekjes të jatin!

Stefani fliste shkurt. Fjalët mezi i dilnin. Siku i ngecni në grykë. Pandora e dëgjonte në heshtje. Edhe himarjotët e tjerë e dëgjonin në heshtje. Kur mbaroi Stefani tregimin, Pandora tha:

Llambrua është vëllai i Stefanit!

Asnjë nuk foli për ca çaste. Plaku ju afrua Stefanit, e pa mirë e mirë dhe ju hodh në qafë.

— Si s'më shkoi në mend fare. Po ti i ngjan shumë partizanit të plagosur. Kështu ishte edhe ai.

Plaku e përqafonte dhe e puthte.

XI

LAMTUMIRE

RRUGËT e Ostushit zienin nga njerëzit atë mëngjez. Gjëmonin edhe nga këngët, nga bambumet e daulleve dhe nga zëri i çjerë i curleve. Njerëzit kishin ngritur jakat dhe kishin mbështjellë kokat me shalle. Duart i mbanin në xhepa. Doreza s'kish njeri. Ato kishin ngelur nëpër stivat e tulave e të tjegullave, bashkë me copa lëkure nga mollëzat e gishtarinje. Disa i hukatnin duart. Binnte borë dhe frynte erë. Nëpër shtëpi nuk kish mbetur njeri. Kishin dalë rrugëve edhe pleqtë e plakat që mbaheshin me shkop, edhe fëmijët. Kishin dalë edhe nënët me foshnja në duar.

Ostushi përcillte vullnetarët, ushtarët e specialistët. Përcillte edhe shumë ostushas. Të gjithë tok do të shkonin në një fshat tjetër aty afër. Do të shkonin në Balldë. Në Ostush u ndërtuan të gjitha shtëpitë e rrëzuara. U meremetuan edhe të démtu-

arat. Tani do të shkonin të ndihmonin ata të Ball-dës.

Nuk u mbajtën fjalime. Tha disa fjalë Sherif Kajca, anëtari i shtabit të lokalitetit. U thanë pak fjalë. I thanë fshatarët pér vullnetarët, specialistët e ushtarët. Pér të gjithë ata që kishin ardhur në Ostush. I thanë vullnetarët, ushtarët e specialistët pér fshatarët. U shternguan duar, u bënë përqafime, u fshinë lot në cepat e syve.

Ostushi përcillte vullnetarët, ushtarët e specialistët. Edhe disa ostushas. Përcillte edhe Stefanin. E përcillte plaku me fener në dorë, e përcillte Myftari me të shoqen e me fëmijët. E përcillnin gjithë ostushasit.

U vunë në njëshkolonë. Në krye printe një ushtar me flamur. Nga pas vinte brigadier i «21 dhjetorit». Pas tij vinte Stefani. Pas Stefanit një ushtar tjetër. Pas ushtarit Marku. Pas Markut një punëtor. Ushtarë, punëtorë e fshatarë ishte gjithë kolona. Ata ecnin duke çarë borën gjer në gju. Fshatarët u tundnin shamitë, kapelet, shallet. Vullnetarët, specialistët e ushtarët tundnin veglat e punës: kazma, lopata, çekiçë, mistri. Edhe pushkë.

Matanë kufirit, dy tre vetë që po prisnin dru në pyll, tundnin qeleshet në ajër. Ishin vëllezër kosovarë nga të Dibrës së Madhe. Ishin nga Koxha-ku. Gëzonin edhe ata me ostushasit bashkë, edhe pse ishin pa strehë, edhe pse gdhiheshin nëpër shpella e gropë me kashtë, si ajo që kish ndërtuar Hysen Lula më 1942.

I pa brigadier i «21 dhjetorit» dhe i përshën-

deti. I përshëndeti edhe Stefani. Edhe ushtari me flamur. I përshëndeti gjithë kolona vëllezërit kosovarë.

Ostushi, me oxhakët që nxirrnin tym dhe me flamurët e kuq mbi çatitë, mbeti prapa.

Vullnetarët, ushtarët e specialistët ikën nga Ostushi, po ostushasit, nuk kanë për t'i harruar kurrë. Nuk ka për t'i harruar Hyseni, që s'don të ta ndërtonte shtëpinë te sheshi ku kish qenë tyrbja, plaku me fener në dorë, që e kish dërguar vajzën në hekurudhë, Myftari me fëmijët. Nuk ka për t'i harruar askush. Çdo gjë mund të harrojë ostusnasi, po dhjetorin e 1967-ës nuk do ta harrojë kurrë. As ata, as të tjërët që do të vinë paş tyre.

Kolona ecte. Nuk ecte, po çante përpara. Çante borën, çante erën, çante të ftohit. Me flamur përpara e me vegla në krahë, të dukej se kishe para syve kolonën partizane. Kolonën partizane që ecte me këngë në gojë, sikurse ecnin tani vullnetarët, specialistët e ushtarët. Kolonën partizane ku ecte Llambrua me djalin e plakut me fener në dorë, ashtu siç ecnin tani brigadieri i «21 dhjetorit» dhe Stefani.

Stefani ecte dhe në dorë shtrëngonte diçka. Ish një letër. Një letër e thjeshtë, ku vullnetarët, specialistët, ushtarët e fshatarët kishin vënë nga një fjalë të zemrës. Edhe shkrimtari me gazetarin, edhe Marku, kishin vënë nga një fjalë në atë letër. Ish një letër që do t'ja dërgonin shokut Enver. Do t'i jepnin sihariqin e madh: në Ostush u ngritën të gjitha shtëpitë për shtatëmbëdhjetë ditë. Tani do

të shkonin të ndihmonin ata të Balldës.

Dolën në rrugë. Aty kishin ndaluar maqina dhe njerëz. Ndalan edhe ata. Brigadier i «21 dhjetorit» eci përpara, takoi anëtarët e shtabit të lokalitetit dhe u kthyte shokët. U afroa te Stefani dhe i tha:

— Letra s'na duhet më. . .

— Pse?

— Do t'ja themi me gojë të gjitha shokut Enver. Për pak minuta do ta kemi në mes tonë. Ka ardhur të vizitojë të dëmtuarit nga tërmeti.

EPILOG

Në tryezë ishin shtruar gjithë ata njerëz. Në vatër digjej zjarri.

Në krye rrinte Liria. E dini kush është Liria? Eshtë bija e Myftarit. Është një nga fëmijët që Stefanë i dha mandarina natën që vajti në Ostush. Është një nga fëmijët, që mëngjez, drekë e darkë i conte ushqimet Stefanit. Është ajo vajza e vogël që i ngjan aq shumë Lumes. Atë e mori me vete Stefanë në Himarë. E mori që të shikojë bregdetin. E mori që të shikojë Çikën, Karaburunin dhe Llogoranë. E mori që të shikojë bahçet me portokalle, me ullinj dhe me limona. E mori që ta festonin bashkë Vitin e Ri.

Në krye të tryezës rrinte mikja e vogël nga Ostushi i Dibrës. Më poshtë rrinte Fitorja. Fitorja e partizanit që rrinte në tavanin e shtëpisë së plakut me fener në dorë. Fitorja, që nuk e njohu të jatin. Më poshtë rrinte Stefanë. Pastaj të tjerët me radhë.

Në tryezë, një vend ishte bosh. Aty ish vendi

i Llambros. Llambrua nuk ishte më. Po në mur ishte fotografia e tij. Jo ajo që u gjet në gërmadhat e shtëpisë së plakut me fener në dorë. Një tjetër, më e madhe, e nxjerrë nga fotografia. e vogël.

Gëzonin njerëzit në tryezë. Gëzonte Liria që i ngjante aq shumë Lumes. Gëzonte Fitorja që nuk e njohu të jatin. Gëzonte edhe Stefani. Gëzonin edhe të tjerët. Gëzonte edhe Llambrua që nga fotografia.

Dera trokiti. Hyri postieri. Një tufë me letra dhe kartolina. Vinin nga afër e nga larg. Në mes të tyre një kartolinë nga Tirana, një tjetër nga Dibra dhe një e tretë nga Dukagjini. Njerën e dërgonte brigadieri i «21 dhjetorit», tjetrën Myftari, babai i Lumes dhe i Lirisë, të tretën Marku.

Stefani i lexoi të tria dhe pastaj ra në mendime...

«Ndofta në këto çaste Myftari, brigadieri i «21 dhjetorit» dhe Marku janë duke lexuar kartolinat e mia. Ata nuk do t'i harroj kurrë. As ata nuk do të më harrojnë mua. Ne nuk do ta harrojmë kurrë njeri tjetrin. Ne nuk do ta harrojmë kurrë dhjetorin e 1967-ës;»

Tiranë, dhjetor 1967 — janar 1968

PERMBAJTJA

I.	Këmisha	5
II.	Plaku me fener në dorë	17
III.	Nën rrotat e makinës	25
IV.	Hyseni dorëzohet	34
V.	Gropa me kashtë	43
VI.	Ushtari nga Dukagjini	52
VII.	Kushtet teknike dhe rinia	64
VIII.	Në ujrat e Drinit	73
IX.	Shtëpia e fundit	80
X.	Çanta e partizanit pa emër	88
XI.	Lamtumirë	93
	Epilog	97